

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XVIII, nr. 5644
E martë, 4 dhjetor 2018
çmimi 0.40 €

LAMTUMIRË PRESIDENT I AMERIKËS!

FAQE 13



ISMET
SYLEJMANI

Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

AKTUALE

**GJYKATA KUSHTETUESE
E VLERËSON TË
PAPRANUESHME KËRKESËN
E THAÇIT PËR KOZ-në F. 6**

**MË 14 DHJETOR MBAHET
SEANCA PËR VOTIMIN E
USHTRISË F. 6**

**LANSOHET FUSHATA
'TË SIGURT NË RRUË
GJATË DIMRIT' F. 7**

EKONOMI



**NË 'PRISHTINA 2018'
BËHET THIRRJE TË MOS
NGREHEN ÇMIMET F. 9**

**MINISTRI SHALA FTON
BIZNESET E VOGLA DHE TË
MESME TË APLIKOJNË NË
PROGRAMIN COSME F. 8**

KULTURË

**KARAKTERI KOMBËTAR I
SHKOLLËS SË PARË SHQIPE
PËR VASHA F. 13**

Prof. dr. Sabile Keçmezi - BASHA

SPORT

**FERONIKELI I DYTI,
HOXHA: SEZON POZITIV F. 16**

KOMISIONARI EVROPIAN PËR POLITIKA TË FQINJËSISË DHE NEGOCIATA TË ZGJERIMIT, JOHANNES HAHN, KA VIZITUAR KOSOVËN

As këtë vit vizat, Hahni përmend vitin 2020

Komisionari Evropian për Politika të Fqinjësisë dhe Negociata të Zgjerimit, Johannes Hahn, ka konfirmuar të hënën në Prishtinë se këtë vit nuk do të ketë liberalizim të vizave për qytetarët e Kosovës. Pas takimeve që ka pasur me liderët institucionalë, ai ka thënë se Kosova i ka kryer punët që i kanë takuar në lidhje me procesin e liberalizimit të vizave, duke shtuar se tani çështja është te Këshilli i BE-së. Sipas Hahnit, kjo është procedurë që merr më së shumti kohë në këtë proces. Zyrta i lartë i BE-së ka përmendur vitin 2020 si mundësi reale ku qytetarët e Kosovës do të mund të lëviznin pa viza në Zonën Shengen



Kosnetti: ShBA-ja do ta vazhdojë mbështetjen për Kosovën

FAQE 3



Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA) do ta vazhdojnë mbështetjen për Republikën e Kosovës. Ky është zotimi që ka dhënë të hënën në Prishtinë ambasadori i ri i ShBA-së në Kosovë,

Philip Kosnett. Ai ka vlerësuar se partneriteti në mes të ShBA-së dhe Kosovës është shumë i fuqishëm dhe, sipas tij, nuk ka vende tjera në botë që ndajnë miqësi më të afërt sesa Amerika dhe Kosova



Qytetarët nuk marrin barnat e nevojshme dhe në kohën e duhur

FAQE 6

RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepcisht-Tetovë
Curëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVE
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë, p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

NATO-ja e mbështet dialogun midis Kosovës dhe Serbisë

Shefi i NATO-s, Jens Stoltenberg, tha se aleanca e mbështet plotësisht dialogun për normalizimin e marrëdhënieve midis Prishtinës dhe Beogradit, kurse sa i përket ndryshimit të mundshëm të kufijve, tha se shpreson se palët do të jenë në gjendje të gjejnë një zgjidhje të pranueshme për Beogradin he për Prishtinën

BRUKSEL, 3 DHJETOR - Ministrat e punëve të brendshme të vendeve anëtare të NATO-s do të takohen sot (e martë) dhe nesër (e mërkurë) në Bruksel. Në ditën e dytë pritet të bisedohet për Ballkanin Perëndimor dhe dialogu midis Kosovës dhe Serbisë pritet të jetë, po ashtu, temë e diskutimeve.

Shefi i NATO-s, Jens Stoltenberg, tha të hënën se aleanca e mbështet plotësisht dialogun për normalizimin e marrëdhënieve midis Prishtinës dhe Beogradit. "Është e rëndësishme që të gjithë lojtarët të përmbahen nga veprimet dhe retorika provokuese dhe të bëjnë përpjekje që t'i zvogëlojnë tensionet dhe të shënojnë përparim", tha Stoltenbergu. "Sa i përket ndryshimit të mundshëm të kufijve, mund të them se ne e mbështesim dialogun dhe shpresoj se palët do të jenë në gjendje të gjejnë një zgjidhje të pranueshme si për Beogradin, po ashtu edhe për Prishtinën",

tha Stoltenbergu.

Ai shtoi se misioni paqeruajtës i NATO-s, KFOR, do të vazhdojë të jetë i pranishëm në Kosovë, për të ndihmuar në ruajtjen e stabilitetit dhe të sigurisë.

Ideja për ndryshim kufijsh është shpalosur nga presidenti i Kosovës dhe i Serbisë, Hashim Thaçi dhe Aleksandar Vuçiq, si mundësi për zgjidhjen e problemeve midis dy vendeve.

Shefi i NATO-s ka konfirmuar se Bosnjë e Hercegovina ka pranuar planin e veprimit për anëtarësimin në NATO. "Nga Bosnjë e Hercegovina do ta kërkojmë përgatitjen e programit të parë vjetor. Tani është në anën e autoriteteve të Bosnjës nëse do ta pranojnë këtë ofertë" ka thënë Stoltenbergu.

Ky është hapi i parë në procesin e anëtarësimin të plotë të këtij shteti në aleancën veriatlantike. Secilit shtet që synon anëtarësimin në NATO i kërkohet ta përpilojë planin vjetor të përgatitjeve për anëtarësim.



Rama: Marrëdhëniet tona me Greqinë, historike dhe tradicionale

TIRANË, 3 DHJETOR - Kryeministri shqiptar Edi Rama i ka karakterizuar "historike dhe tradicionale" marrëdhëniet midis Shqipërisë dhe Greqisë, në një intervistë të shkurtër për drejtorin e përgjithshëm të agjencisë shtetërore greke "ANAMPA", Mihail Psilou, në kuadrin e konferencës "Fake News dhe raporti me të vërtetën", që organizoi agjencia shqiptare e lajmeve ATSh në Tiranë. "Është një marrëdhënie historike dhe tradicionale e fqinjësisë dhe, siç gjithmonë ndodh me fqinjët,

nuk është gjithçka perfekt. E dimë këtë nga rajoni ynë, me çdo fqinj, qoftë në fshat apo në qytet, ose midis vendeve, është gjithmonë e njëjta marrëdhënie", ka vënë në dukje kreu i Qeverisë shqiptare. "Mund ta kuptoni plotësisht këtë, nëse shikoni një ndeshje futbollit midis fqinjëve, është si luftë", ka deklaruar duke qeshur ai, i cituar në artikullin përkatës.



Por, Rama ka theksuar se "ne jemi shumë të gatshëm ta përmirësojmë këtë marrëdhënie çdo ditë dhe e bëjmë këtë". Në fund, udhëheqësi shqiptar ka

vënë në dukje se "ndonjëherë ka gjëra që janë rastësisht negative, ato ndodhin dhe duhet t'i përballojmë". Por kryesorja, ka thënë ai, është fakti se marrëdhënia mes dy vendeve tani është e mirë dhe nuk ka armiqësi mes popujve. "Grekët e duan Shqipërinë, shqiptarët e duan Greqinë. Pjesa tjetër është vetëm politikë", ka theksuar midis të tjerash Rama. I pyetur nëse planifikohet një

takim mes tij dhe kryeministrit Tsipras, ai është përgjigjur:

"Pritet të takohemi së shpejti. Nuk e di se ku, në Tiranë apo në Athinë, por pritet të takohemi së shpejti. Jemi në një proces të një dialogu shumë intensiv dhe të diskutimeve për shumë çështje, që mbulojnë shumë vite, si dhe të çështjeve të tjera që kurrë nuk janë shtruar me vullnet të plotë, kurajë dhe vendosmëri për t'i zgjidhur. Besoj se jemi shumë pranë që t'i zgjidhim këto, e kjo do të ishte diçka me vlerë", ka thënë kryeministri Rama.

Macroni anulon vizitën në Serbi

Beograd, 3 dhjetor - Presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, tha se vizita e presidentit të Francës, Emmanuel Macron, e planifikuar për këtë javë në

Beograd, është anuluar për shkak të trazirave në Francë. Vuçiqi tha se ka biseduar me Macronin dhe se ai "e ka lutur që vizita të shtyhet për disa javë". "E di se sa e vështirë

është të realizohen reforma të përgjegjshme ekonomike", tha Vuçiqi në një konferencë me gazetarë në Beograd. Qe disa fundjavë Lëvizja "Jelekët e verdhë" organizon

protesta në Francë, në kundërshtim të rritjes së paralajmëruar të çmimit të karburanteve, në kuadrin të disa masave për mbrojtjen e mjedisit.



Ambasadori i ri i Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA) në Kosovë, Philip Kosnett, i ka dorëzuar letrat kredenciale presidentit Hashim Thaçi

Kosnetti: ShBA-ja do ta vazhdojë mbështetjen për Kosovën

Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA) do ta vazhdojnë mbështetjen për Republikën e Kosovës. Ky është zotimi që ka dhënë të hënën në Prishtinë ambasadori i ri i ShBA-së në Kosovë, Philip Kosnett. Ai ka vlerësuar se partneriteti në mes të ShBA-së dhe Kosovës është shumë i fuqishëm dhe, sipas tij, nuk ka vende të tjera në botë që ndajnë miqësi më të afërt sesa Amerika dhe Kosova

**EPOKA
ERE** Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 3 DHJETOR - Ambasadori i ri i Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Kosovë, Philip Kosnett, të hënën i ka dorëzuar letrat kredenciale presidentit Hashim Thaçi, me ç'rast ka thënë se Amerika është këtu për ta mbështetur Kosovën. Ai ka theksuar se bashkëpunimi në mes të ShBA-së dhe Kosovës është i pakrahueshëm. Kosnetti e ka quajtur nder të madh për të dhe familjen e tij që të jenë në Kosovë. "Unë kam shërbyer për një kohë të shkurtër në Ambasadën e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Kosovë para 15 vjetësh. Është nder dhe kënaqësi e jashtëzakonshme të kthehesh dhe ta shohësh përparimin që Kosova tashmë e ka bërë në rrugën drejt prosperitetit, drejtësisë, paqes dhe vendosjes së marrëdhënieve të mira me fqinjët. I gëzohem mundësisë për të punuar për së afërmi me ju, me ministrinë dhe, po ashtu, edhe me popullin e Kosovës, përveçse me qeverinë, për ta bërë të qartë se Shtetet e Bashkuara janë këtu për t'ju mbështetur. Partneriteti në mes të

Shteteve të Bashkuara dhe Kosovës nuk ka krahasim askund në botë. Nuk ka dy shtete të cilat janë më të afërta se Shtetet e Bashkuara dhe Kosova", është shprehur ambasadori Kosnett pas takimit me presidentin Thaçi. Ndërsa presidenti Hashim Thaçi i ka uruar suksese ambasadorit të ri të ShBA-së në Kosovë, duke thënë se me padurim pret t'i fillojnë angazhimet e përbashkëta në një agjendë të koordinuar mirë e cila nënkupton fqinjësi të mirë, zhvillim ekonomik, rend dhe ligj dhe të ardhme euroatlantike. "Ambasadori Kosnett ka shërbyer edhe më herët në Kosovë dhe do ta vazhdojë punën këtu. Jemi shumë mirënjohës për mbështetjen e vazhdueshme në tri dekadat e fundit dhe besoj se edhe në kapitullin e tretë do ta realizojmë një agjendë të përbashkët dhe të koordinuar, që nënkupton të ardhme euroatlantike, harmoni mes njerëzish dhe fqinjësi të mirë", ka theksuar Thaçi, duke shtuar se kishte kënaqësinë që javën e kaluar ta takonte dy herë ambasadorin Kosnett në Uashington, një herë në takim dhe një herë me sekretarin Pompeo, pastaj gjatë betimit të tij



në Departamentin Amerikan të Shtetit. "Ambasadori Kosnett është njeri me fat që do të shërbejë në një vend me popullatën më proamerikane në botë", ka thënë Thaçi. Ambasadori amerikan është prituri të hënën në takim edhe nga kryeministri Ramush Haradinaj i cili ka ofruar bashkëpunim të sinqertë dhe punë të përbashkët për të mirën e Kosovës, por edhe të rajonit dhe marrëdhënieve të ndërsjella. "Është nder i posaçëm t'ju prezantoj me ambasadorin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, z. Philip Kosnett, që sapo ka filluar punën në Kosovë. Shfrytëzova rastin ta uroj për punën që e ka marrë dhe për nderin që do ta kemi për të punuar bashkë në të


ardhmen, për të mirën e popullit të Kosovës dhe popullin e Amerikës, si dhe për marrëdhëniet bilaterale", ka deklaruar Haradinaj. Kryeministri e ka njoftuar ambasadorin Kosnett për proceset politike dhe ato ekonomike nëpër të cilat është duke kaluar Republika e Kosovës. Në të njëjtën kohë Haradinaj i ka falënderuar Shtetet e Bashkuara të Amerikës për mbështetjen e Kosovës në të gjitha fushat. Kurse ambasadori i ShBA-së, Philip Kosnett, ka thënë se është një privilegj dhe nder kthimi i tij në Kosovë pas 15 vjetësh për të shërbyer ambasador i Amerikës. "Partneriteti në mes të ShBA-së dhe Kosovës është shumë i fuqishëm. Unë nuk njoh ndonjë

vend tjetër në botë që ndan një miqësi kaq të afërt sesa Amerika dhe Kosova. Pres me padurim të punoj nga afër me kryeministrin Haradinaj në shumë çështje të ndryshme, si ekonomia, sundimi i ligjit, siguria, raporti i Kosovës me fqinjët e saj. Mendoj se jemi në një moment të historisë ku njerëzit duhet të marrin vendime të cilat do të mbahen në mend edhe në të ardhmen", ka theksuar Kosnett, duke e falënderuar kryeministrin Haradinaj për miqësinë dhe sinqeritetin. Ambasadori i ri i Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA), Philip Kosnett, të martën do të takohet edhe me zëvendëskryeministrin dhe ministrin e Punëve të Jashtme, Behgjet Pacolli.

Të mërkurën ora e parë e mësimimit do t'i kushtohet ish-presidentit George H. W. Bush

PRISHTINË, 3 DHJETOR (ER) - Ministri i Arsimit, i Shkencës dhe i Teknologjisë, Shyqiri Bytyqi, ka marrë vendim që të mërkurën të gjitha institucionet e arsimit parauniversitar, orën e parë të mësimimit t'ia kushtojnë veprimtarisë politike të ish-presidentit amerikan George H. W. Bush, në funksion të fuqizimit të raporteve në mes të shtetit të Kosovës dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës si dhe përkushtimit të tij për faktorizimin e çështjes së Kosovës në çaste të rëndësishme historike. "Në shenjë respekti, mirënjohje dhe vlerësimi për veprimtarinë politike të ish-presidentit amerikan z. George H. W. Bush, në funksion të fuqizimit të

raporteve mes shtetit të Kosovës dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës, si dhe përkushtimit të tij për faktorizimin e çështjes së Kosovës në çaste të rëndësishme historike, kam marrë vendim që të mërkurën, më 5 dhjetor 2018, të gjitha institucionet e arsimit parauniversitar, orën e parë të mësimimit t'ua kushtojnë raporteve të mira historike në mes të Kosovës dhe ShBA-së në kuadër të mbështetjes së vazhdueshme që i është dhënë vendit tonë gjatë procesit të çlirimit, pavarësisht dhe shtetndërtimit", ka thënë ministri Bytyqi në vendimin e tij. Ish-presidenti amerikan George H. W. Bush ka ndërruar jetë të shtunën në moshën 94-vjeçare.



Komisionari Evropian për Politika të Fqinjësisë dhe Negociata të Zgjerimit, Johannes Hahn, ka vizituar Kosovën

As këtë vit vizat, Hahni për



Komisionari Evropian për Politika të Fqinjësisë dhe Negociata të Zgjerimit, Johannes Hahn, ka konfirmuar të hënën në Prishtinë se këtë vit nuk do të ketë liberalizim të vizave për qytetarët e Kosovës. Pas takimeve që ka pasur me liderët institucionalë, ai ka thënë se Kosova i ka kryer punët që i kanë takuar në lidhje me procesin e liberalizimit të vizave, duke shtuar se tani çështja është te Këshilli i BE-së. Sipas Hahnit, kjo është procedurë që merr më së shumti kohë në këtë proces. Zytari i lartë i BE-së ka përmendur vitin 2020 si mundësi reale kur qytetarët e Kosovës do të mund të lëviznin pa viza në Zonën Shengen

EPOKA E RE

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 3 DHJETOR - Komisionari Evropian për Politika të Fqinjësisë dhe Negociata të Zgjerimit, Johannes Hahn, ka bërë me dije të hënën se këtë vit nuk do të ketë vendimarrje të Bashkimit Evropian për liberalizim të vizave për Kosovën. Në një konferencë për medie, të cilën e ka mbajtur në Prishtinë, në zyrën e BE-së, pas takimeve që ka pasur me liderët institucionalë të Kosovës, ai ka thënë se institucionet e Kosovës i kanë kryer obligimet që kanë pasur për këtë proces, por procedura e vendimarrjes në Këshill

të BE-së merr kohë. Si datë realiste, në të cilin qytetarët e Kosovës do të mund të lëvizin pa viza në Zonën Shengen, Hahn ka përmendur vitin 2020. "Puna është kryer nga Kosova dhe ishte radha jonë ta implementojmë. Kjo ka nisur me raportin dhe është marrë Parlamenti, i cili ka vendosur me një shumicë. Tash çështja ndodhet në Këshillin Evropian, i cili merr më së shumti kohë për ta kaluar këtë hap të procesit dhe kam besim se viti 2020 është më realisti, por mos u bëni peng i numrave", ka thënë Hahn. Ai ka ftuar qytetarët e Kosovës të kenë durim për këtë proces. "E kuptoj plotësisht padurimin e qyte-

tarëve, edhe të politikanëve, por më besoni se edhe unë nganjëherë jam i padurueshëm. Ndërsa sa iu përket proceseve vendimmarrëse në BE, një pjesë e flokëve të mia të thinjura janë për shkak të këtyre procedurave. Komisionari Hahn i 2010-s nuk është sikurse ky i 2018-s për shkak të përvojave që kam pasur. Nëse e krahasoj gjendjen me Ukrainën dhe Gjeorgjinë të cilat janë shtetet e fundit që kanë fituar liberalizimin e vizave, këtyre iu kanë nevojitur një vit e gjysmë për heqjen e vizave. Ne si komisioni përpiqemi ta bëjmë më të mirën. Tani ne e kemi bindur Parlamentin Evropian dhe tani varet nga shtetet anëtare të BE-së


Kosova në vendin e 82-të për nga fuqia e pasaportës

PRISHTINË, 3 DHJETOR - Emiratet e Bashkuara Arabe janë vendi me pasaportën më të fuqishme në botë. Sipas Indeksit të Pasaportave, poseduesit e pas-

aportës së Emirateve mund të udhëtojnë në 167 vende të botës pa viza paraprake. Sipas këtij indeksi online, Singapori dhe Gjermania ndajnë vendin e dytë,

Danimarka të tretin. Indeksi i Pasaportave rendit pasaportat e 193 vendeve anëtare të Kombeve të Bashkuara dhe gjashtë terri-toreve shtesë. Nga vendet e

Balkanit, Kosova zë vendin e 82-të, Shqipëria të 43-in, Bosnja e Hercegovina të 41-in, Mali i Zi të 38-in, Maqedonia të 37-in dhe Serbia të 32-in.



mend vitin 2020

dhe e zhgënjyer me këtë veprim të Qeverisë së Kosovës. Ai ka thënë se heqja e barrierave tregtare është një nga qëllimet e BE-së. "Ne të gjithë kemi qenë të befashuar dhe të zhgënjyer kur u vendos tarifa prej 100-përqindësh. Jam në dijeni dhe të gjithë në BE jemi për vështirësitë aktuale për Kosovën. Ka nevojë që të dyja palët t'i adresojnë këto çështje", ka deklaruar Hahn. Ndërsa kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka përsëritur qëndrimin e tij se taksa prej 100-përqindësh që ua ka vënë Kosova prodhimeve të importuara nga Serbia dhe Bosnje e Hercegovina nuk do të hiqet.

Në një konferencë për media, pas takimit me komisionarin Hahn, kryeministri Ramush Haradinaj ka thënë se edhe zyrtarët të BE-së ia ka shpjeguar se Kosova ka qenë e detyruar për ta vendosur këtë taksë për mallrat serbe. "Ne do ta respektojmë vendimin e qeverisë dhe ky vendim mund të anulohet me rastin e njohjes së pavarësisë së Kosovës nga Serbia. Ne do të punojmë që tani të nënshkruajmë një marrëveshje gjithëpërfshirëse (me Serbinë), ku do të jetë tema për të zhdukurit, borxhet. Një ndër temat do të jetë edhe njohja", është shprehur Haradinaj.

Kreu i Qeverisë e ka pranuar se nuk ka marrë garanci nëse çështja e liberalizimit të vizave për Kosovën do të jetë në agjendë të Këshillit të BE-së që do të mbahet këtë javë. "BE-ja ka skepticizëm. Jep shumë arsye, prej atyre që kjo është e logjikshme. Thotë se për Ukrainën dhe Gjeorgjinë ka zgatur një vit e gjysmë periudha kohore në mes të komisionit dhe vendimit. Nuk përjashtohet mundësia në një të ardhme të afërt, sepse këshilli mbledhet çdo tre muaj, mirëpo nuk na japin një garanci se do të ndodhë kësaj here", ka deklaruar kryeministri Haradinaj.

Komisionari Evropian për Politikën të Fqinjësisë dhe Negociatave të Zgjerimit, Johannes Hahn, gjatë ditës ka takuar edhe liderët e tjerë nacionalë.

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka deklaruar se me komisionarin Johannes Hahn ka biseduar për të ardhmen evropiane të Kosovës, duke e ftuar atë për një angazhim më të madh të BE-së në Kosovë dhe rajon. "E vlerësoj vizitën dhe angazhimin tuaj për zgjidhjen e problemeve", është shprehur presidenti Thaçi. Kurse me kryetarin e Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, komisionari i BE-së ka biseduar për procesin e liberalizimit të vizave për Kosovën, dialogun me Serbinë si dhe për reformat që Kosova po bën në shumë fusha. Sipas një komunikate për medie, kryeparlamentari Veseli ka falënderuar komisionarin Hahn për mbështetjen që Bashkimi Evropian i ka dhënë Kosovës. Ai ka theksuar se qytetarët e Kosovës presin që BE-ja të jetë unike sa i përket heqjes së vizave, pasi tashmë çdo kriter është plotësuar. Sa i përket dialogut me Serbinë, Veseli ka theksuar se Kosova është e përkushtuar për arritjen e një marrëveshjeje finale, që do t'i zgjidhë njëherë e përgjithmonë të gjitha çështjet e hapura, në të njëjtën kohë i hapë rrugë Kosovës për anëtarësim në Bashkimin Evropian, OKB, NATO dhe organizata të tjera. Komisionari Hahn, i cili në Kosovë ka ardhur pas një vizite në Serbi, është prituri në Merdare nga Ministrja e Integritimit Evropian, Dhurata Hoxha. Kjo e fundit në profilin e vet në "Facebook" ka shkruar se kjo vizitë është me rëndësi sepse është e lidhur me klimën aktuale në raportet e Republikës së Kosovës me fqinjët, me mesazhe të paralajmëruara për promovimin e fqinjësisë së mirë dhe bashkëpunim rajonal.

LETRA (QË NUK MË LEXOHEM) DREJTUAR KOMISIONARIT HAHN



ADEM GASHI

Z. Hahn, nuk dyshoj se ju e njihni lidhshimin e Kosovës. Nuk dyshoj se e dini që nuk i ka përmbushur as për së afërmi kushtet e detyrueshme sipas kërkesave tuaja: kushtin e sundimit të ligjit dhe të luftimit të korrupsionit të tmerrshëm që po na gërryen.

Nuk po ju pyes as përse ia liberalizuat vizat Serbisë, shkaktues së luftërave e të tmerreve në Ballkan, ndërkohë që neve na e tundni shaminë shantazhuese të 2020-s; nuk po ju pyes as përse nuk i vini në shenjë mospërmbushjet e marrëveshjeve që ka nënshkruar Serbia për mospengim të Kosovës për aderim në organizmat ndërkombëtare (Interpol, UNESCO etj); nuk po ju pyes as për të tjerat që janë shumë.

Po, një pyetje, pavarësisht prej zemërgjerësisë sime, nuk e shmang: Ç'është tani

ky presioni i taksës? Ne presim me net e me ditë, me muaj e me vite (e dini ç'janë dy dekada pritje!?) për më të dashurit tanë të rrëmbyer e të zhdukur nga Serbia.

Zotëri Hahn, ne presim eshtra. Dhe po lodhemi e po vuajmë, po plakemi e po vdesim nën tiraninë e pritjes. Nuk besoj të mos e dini ju se pleqtë e plakat tona, nuset e fëmijët e foshnjat nuk vajtën në Serbi të luftonin. Ne mendonim se tregtarët e "shpitrave të vdekur" të Gogolit s'ishin veçse personazhe të imagjinatës së shkrimtarit. Po ja ku na u shfaqën Çiçikovët serbë në shekullin XXI, z. Hahn.

Duke qenë me vokacion shkrimtari s'gjej ngushëllim tjetër, Komisionari Hahn, veçse ta shkruaj Baladën për ESHTRAT dhe Satirën për TAKSËN.

E dini se në fjalorin mortar ka një nocion: KENOTAFË. Ky kuptohet edhe në gjuhën tuaj, edhe në të gjitha gjuhët e Evropës. Janë varret boshe, z. Hahn, janë edhe mbi 1 600 kenotafë të hapura.

Nejse. Duke e ditur që nuk më lexohet as kjo letër, nuk po lodhem ta përkthej në asnjë gjuhë.

Le të jetë gjëma ime. Kaq.

Prishtinë, 3. 12. 2018

që ta marrin këtë vendim. Tashmë kanë filluar ta shqyrtojnë këtë, por kjo merr kohë", ka thënë Hahn.

Në adresim e tij për medie, ai ka folur edhe për taksën prej 100 përqindësh që Qeveria ka vendosur për mallrat serbe, duke thënë se BE-ja është e befashuar

Gjykata Kushtetuese e vlerëson të papranueshme kërkesën e Thaçi për KOZ-në

Prishtinë, 3 dhjetor (ER) - Gjykata Kushtetuese e Kosovës nuk i ka dhënë përgjigje presidentit të Kosovës, Hashim Thaçi, rreth dilemës së tij për përbërjen e re të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ). Pas disa muajsh shqyrtimi të kërkesës, Kushtetuesja ka vendosur që kërkesën e Thaçit ta vlerësojë "të papranueshme".

Parashtruesi i kërkesës kishte kërkuar nga Gjykata Kushtetuese interpretimin e nenit 139 [Komisioni Qendror i Zgjedhjeve], paragrafi 4, të

Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke shtruar pyetjet nga cilat grupet parlamentare duhet të emërohen anëtarët e KQZ-së.

Dilema e Thaçit është nëse anëtarët e KQZ-së duhet të emërohen nga grupet parlamentare që kanë dalë nga subjektet politike që i kanë fituar zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës apo nga grupet parlamentare që janë krijuar pas konstituimit të Kuvendit të Kosovës. "Gjykata fillimisht vlerësoi nëse kërkesa e parashtruar i plotëson kushtet e

pranueshmërisë, sikurse që janë përcaktuar me Kushtetutë dhe që janë saktësuar më tej në Ligjin për Gjykatën Kushtetuese dhe në Rregulloren e punës së gjykatës. Gjykata gjeti se çështjet e ngritura nga parashtruesi para gjykatës nuk hyjnë në fushëveprimin e juridiksionit të Gjykatës Kushtetuese, siç përcaktohet në nenin 113. Rrjedhimisht, në pajtim me nenin 113, paragrafi 1 të Kushtetutës, Gjykata përfundoi se kërkesa është e papranueshme", thuhet në komunikatën e Gjykatës.



Më 14 dhjetor mbahet seanca për votimin e ushtrisë

Kryesia e Kuvendit të Kosovës ka vendosur që në javën e ardhshme, më 14 dhjetor, të mbahet seanca në të cilën do të shqyrtohen në lexim të dytë pakoja e projektligjeve për Forcën e Sigurisë së Kosovës që përfshinë: Projektligjin për Ministrinë e Mbrojtjes, Projektligjin për Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe Projektligjin për shërbim në Forcën e Sigurisë së Kosovës



PRISHTINË, 3 DHJETOR (ER) - Kryesia e Kuvendit të Kosovës, e drejtuar nga Kadri Veseli, kryetar, ka mbajtur të hënën mbledhjen e radhës, në të cilën ka vendosur që në javën e ardhshme (më 14 dhjetor), në orën 10:00, Kuvendi pritet ta miratojë në shqyrtim të dytë pakon e projektligjeve për Forcën e Sigurisë së Kosovës që përfshinë: Projektligjin për Ministrinë e Mbrojtjes, Projektligjin për Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe Projektligjin për shërbim në Forcën e Sigurisë së Kosovës. Veseli pas mbledhjes së Kryesisë ka thënë se më 14 dhjetor Kosova edhe zyrtarisht do ta ketë ushtrinë e vet. "Më 14 dhjetor 2018 do ta kemi zyrtarisht

Ushtrinë e Kosovës. Kjo është data kur në Kuvendin e Kosovës do t'i votojmë Projektligjet që e transformojnë FSK-në në ushtri. Na priftë e mbara dhe urime të gjithëve!", ka shkruar Veseli. Po më 4 dhjetor, në orën 17:00, do të vazhdojë seanca plenare e Kuvendit, me pikat e papërfunduara më 13 shtator, 18, 31 tetor, 2, 7 dhe 23 nëntor 2018, si dhe seanca tjetër, po ashtu me pikat e papërfunduara më 23 nëntor. Të enjten, më 6 dhjetor, në orën 10:00, Kuvendi do të mbledhet në seancë të re. Në këtë seancë, pas deklarimeve jashtë rendit të ditës dhe pyetjeve parlamentare, deputetët do ta shqyrtojnë për herë të parë Projektligjin mbi ndarjen buxhetore për buxhetin e

Republikës së Kosovës për vitin 2019. Për herë të parë do të shqyrtohen edhe tri projektligje të tjera: Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Këshillin Ekonomiko-Social, Projektligji për produktet biocide dhe Projektligji për Odën e Arkitektëve dhe Odën e Inxhinierëve në fushën e ndërtimit. Në vazhdim do të bëhet shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për familjen.

Kuvendi do t'i vazhdojë punimet me shqyrtimin e raportit të auditimit për pasqyrat vjetore financiare të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit për vitin 2017, raportin për gjendjen e mjedisit në Kosovë për vitin 2017, emërimin e një anëtari të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës dhe zgjedhjen e një anëtari të Komisionit të Pavarur për Media. Kryesia e Kuvendit në mbledhjen e së hënës u njoftua me

vendimin e presidentit për kthimin e Ligjit për lirinë e asociimit në organizata joqeveritare. Kryesia ngarkoi komisionin funksional për shqyrtimin e këtij projektligji. Projektligji për pastërtinë e figurës së zyrtarëve të lartë në institucionet publike dhe të të zgjedhurve do t'u shpërndahet deputetëve dhe do të shqyrtohet nga komisioni funksional, pasi për të njëjtin Qeveria nuk ka dhënë ndonjë mendim.

Qytetarët nuk marrin barnat e nevojshme dhe në kohën e duhur

Zyra Kombëtare e Auditimit ka vlerësuar se Lista Esenciale e Barnave nuk është azhurnuar që nga viti 2013 dhe ekziston rreziku që barna të rëndësishme dhe me kosto efektive mos të jenë në këtë listë. Po ashtu, kjo zyrë ka theksuar se gjendje jo më e mirë është edhe te shpërndarja e barnave



**EPOKA
ERE** **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 3 DHJETOR - Zyra Kombëtare e Auditimit ka kryer auditimin e menaxhimit të Listës Esenciale të Barnave dhe ka nxjerrë disa rezultate të rëndësishme për menaxhimin më efikas të saj. Lista nuk është azhurnuar që nga viti 2013 dhe ekziston rreziku që barna të rëndësishme dhe me kosto efektive mos të jenë në këtë listë. "Rreth 30 për qind e barnave nuk porositen asnjëherë, ndërsa ka barna të rëndësishme të cilat janë kërkuar në vazhdimësi, mirëpo nuk janë përfshirë në listën esenciale. Ky auditim ka konkuludar mangësi në të gjithë procesin e menaxhimit të listës esenciale të barnave duke filluar nga planifikimi, shpërndarja dhe monitorimi i këtij procesi nga institucionet shëndetësore. Planifikimet fillestare janë ndryshuar pa analiza përkatëse dhe si pasojë një bar vital është

reduktuar deri në 74 për qind nga plani fillestar", thuhet në raport. Më tej, në raport theksohet se gjendje jo më e mirë është edhe te shpërndarja e barnave, ku për shkak të mospërcjelljes së afatit të përcaktuar në kontratat e furnizimit me barna ka ndodhur që të ketë vonesa në dorëzim deri në 240 ditë pas afatit të paraparë. "Si pasojë e mungesës së monitorimit të duhur të procesit të planifikimit dhe shpërndarjes së barnave nga institucionet përgjegjëse, dobësitë e njëjta janë përsëritur çdo vit. Përkundër një buxheti mesatar vjetor për Listën e Barnave për vitet 2015-2017 që ka qenë rreth 15 milionë euro, jashtë kësaj liste vetëm Qendra Klinike Universitare kishte shpenzuar mesatarisht 1.2 milion euro në vit për produkte farmaceutike. Ndërsa se sa shpenzojnë pacientët nga buxheti i tyre për barna që nuk ofrohen nga institucionet shëndetësore nuk ka asnjë të

dhënë në institucionet e Kosovës", është theksuar në raport. Besnik Osmani, Auditori i Përgjithshëm, me rastin e publikimit të këtij raporti, ka theksuar se për të siguruar një furnizim më të mirë me barna Ministria e Shëndetësisë, së bashku me Fondin e Sigurimeve Shëndetësore dhe Shërbimin Spitalor Klinik Universitar, duhet të sigurojnë që Lista Esenciale e

Barnave të azhurnohet sa më shpejt në mënyrë që t'i përfshijë nevojat e pacientëve. "Përveç kësaj, këto institucione duhet të sigurojnë menaxhim më të mirë të planifikimit dhe shpërndarjes së barnave si dhe monitorim të procesit për të siguruar se barnat janë në dispozicion të pacientëve kur u nevojiten", ka thënë Osmani. Zyra Kombëtare e Auditimit ka vlerësuar se Ministria e

Shëndetësisë, Fondi i Sigurimeve Shëndetësore dhe Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës duhet të ndërmarrin hapa konkretë për të siguruar menaxhim të duhur të Listës Esenciale të Barnave. Thuhet në raport se zbatimi i rekomandimeve të cilat ishin rezultat i auditimit do të ndikojë në mënyrë të drejtpërdrejtë në përmirësimin e këtyre proceseve.

Shteti nderon heronjtë Hyzri Talla, Afrim Maliqi dhe Ilir Durmishi

Heronjtë Hyzri Talla, Afrim Maliqi dhe Ilir Durmishi janë sakrifikuar për lirinë e Kosovës. Kujtimi për ta do të jetojë përgjithmonë. Kështu kanë thënë liderët shtetërorë të hënën në akademinë përkujtimore të mbajtur me rastin e 20-vjetorit të rënies së këtyre dëshmorëve

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 3 DHJETOR - Nën përkujdesjen e presidentit të Kosovës, Hashim Thaçi, të hënën është mbajtur akademi përkujtimore me rastin e 20-vjetorit të rënies së heronjve Hyzri Talla, Afrim Maliqi dhe Ilir Durmishi, ku të pranishmit kanë vlerësuar lart kontributin e të rënëve për liri. Presidenti Hashim Thaçi ka thënë se para 20 vjetësh Kosova ka humbur dy veprimtarë të shquar dhe një intelektual në moshën më të mirë krijuese. "Kosova humbi pjesëtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Hyzri Tallën, Ilir Durmishin dhe gazetarin Afrim Maliqi. Rezistenca civile artikulumin më të mirë e arriti përmes organiza-

tës politike dhe ushtarake të dalë nga populli përmes Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. UÇK-ja në radhët e veta bashkoi njerëzit më të përkushtuar dhe më të gatshëm për të luftuar kundër aparatit policor, ushtarak dhe administrativ të Serbisë. Në vitin 1998 Ushtria Çlirimtare e Kosovës ishte forcuar dhe zgjeruar në gjithë Kosovën. Në ofensivat e verës dhe vjeshtës 1998, UÇK-ja u dëshmuar guerile moderne, e pathyeshme dhe e vendosur në qëllimin madhor, çlirimin e Kosovës. Luftëtarët e lirisë dhe populli ishin bërë një, pavarësisht prej çmimit dhe sakrificës", ka deklaruar Thaçi.

Ai ka thënë se një prej luftëtarëve të paepur të UÇK-së ishte edhe Hyzri Talla, i cili kishte një përvojë organizimi në organizata



patriotike që nuk e ndalën asnjëherë veprimtarinë kundër okupimit të Kosovës. "Në kuadër të Zonës Operative të Llapit, Hyzriu kreu me nder dhe përgjegjësi detyra të rëndësishme. Ditën e 2 dhjetorit 1998

Hyzri Talla ishte brenda në Prishtinë në krye të misionit të tij si epror i UÇK-së në Zonën Operative të Llapit. Bashkë me Hyzriun ishte Ilir Durmishi, një veprimtar i përkushtuar. Me ta ishte edhe gazetari i talentuar Afrim Maliqi, shok i idealit të tyre. Vrasja në pritë e këtyre tre veprimtarëve ishte tregues se çfarë rreziku po paraqiste Ushtria Çlirimtare e Kosovës për segmentet e pushtuesit: në fronte, në istikame, në qendra urbane dhe kudo tjetër në Kosovë", ka thënë Thaçi, duke shtuar se Kosova u është mirënjohëse përjetë të gjithë atyre që kanë rënë për lirinë e saj.

Ndërsa kryeparlamentari Kadri Veseli ka thënë se dëshmorët Hyzri Talla, Afrim Maliqi dhe Ilir Durmishi janë sakrifikuar për këtë liri, prandaj kujtimi për ta do të jetojë përgjithmonë. Ai ka thënë se 20-vjetori i rënies së Hyzriut, Afrimit dhe Ilirit, e gjen Kosovën para një momenti historik për të ardhmen siç është transformimi i FSK-së në ushtri të Kosovës. "Dëshmorët Hyzri Talla, Afrim Maliqi dhe Ilir Durmishi u sakrifikuan për këtë

liri, prandaj kujtimi për ta do të jetojë përgjithmonë, sepse përgjithmonë do të jetojnë liria, pavarësia dhe sovraniteti i Kosovës. Ky përvjetor i rënies së Hyzriut, Afrimit, Ilirit e shumë bashkëluftëtarëve dëshmorë, na gjen para një momenti historik për shtetin tonë dhe të ardhmen e tij. Gjatë këtij muaji ne përmbyllim transformimin e FSK-së në Ushtri të Kosovës. Lavdi të gjithë dëshmorëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës", ka deklaruar Veseli.

Kurse kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka thënë se pa heronjtë dhe dëshmorët Kosova nuk do të ishte këtu ku është sot. "Rrugëtimi në rrugën e heronjve është me peshë, nuk është i thjeshtë, është sfidues, por do të angazhohemi të ecim rrugës së tyre së bashku. Ndërsa familjeve dhe të gjithë bashkëluftëtarëve iu themi se pa këta burra, pa këta dëshmorë, pa këta heronj, pa këto flijime, nuk do të ishim këtu. Por edhe pa sfidat e së tashmes nuk mund të ecim në të ardhmen. Kështu që të qëndrojmë së bashku. Lavdi heronjve!", ka thënë Haradinaj.



Lansohet fushata 'Të sigurt në rrugë gjatë dimrit'

PRISHTINË, 3 DHJETOR (ER) - Zëvendësministri i Infrastrukturës, Idriz Selimaj, në bashkëpunim me Departamentin Koordinues të Këshillit për Sigurinë e Komunikacionit Rrugor, Policinë e Kosovës dhe Auto Moto Club Kosova (AMCK) kanë bërë të hënën lansimin e fushatës "Të sigurt në rrugë gjatë dimrit".

Përkritazi me fushatën, zëvendësministri i Infrastrukturës, Idriz Selimaj, solemnisht ka bërë hapjen e kësaj fushate, duke bërë apel të ngasësit e automjeteve që nga

data 15 dhjetor të jenë të pajisur me pajisjet dimërore.

Përmes kësaj fushate Ministria e Infrastrukturës synon vetëdijësimin e qytetarëve të cilët janë pjesëmarrës në trafik gjatë sezonit të dimrit, të jenë të përgatitur dhe t'u kushtohet kujdes i veçantë pajisjeve dimërore, në mënyrë që siguria në rrugë të jetë në nivelin e duhur dhe të eliminohen pengesat të cilat e vështirësojnë qarkullimin e lirë të automjeteve. Njëkohësisht, si formë informimi, Ministria e Infrastrukturës do ta

përdorë shpërndarjen e fletushkave, prej të cilave qytetarët do të mund të informohen më hollësisht rreth përgatitjeve dimërore.

Me moton "Të sigurt në rrugë gjatë dimrit", Ministria e Infrastrukturës, në partneritet me institucionet e tjera relevante për ruajtjen e sigurisë në rrugë, përmes materialeve informuese, pretendon të ofrojë mbështetje dhe të bashkëpunojë në vazhdimësi me ngasësit e automjeteve.



Ministri Shala fton bizneset e vogla dhe të mesme të aplikojnë në programin COSME

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 3 DHJETOR - Ministri i Tregtisë dhe Industrisë, Endrit Shala, ka hapur të hënën konferencën "BE-ja promovon ndërmarrësinë dhe NVM-të: Programi COSME", që ka për qëllimin përkrahjen e bizneseve të vogla dhe të mesme në Kosovë. Ministri Shala ka theksuar se Komisioni Evropian ofron në vazhdimësi ndihmë në aspektin e zhvillimit ekonomik, institucional dhe ndihmon bizneset e vogla dhe të mesme. "Një falënderim i veçantë për Komisionin Evropian për përkrahjen e vazhdueshme që ofron për institucionet e Qeverisë së Kosovës si në aspektin e formimit institucional, zhvillimit të kornizës ligjore, reformave të ndryshme rregullative, ashtu edhe në aspektin e përkrahjes që ofrojnë për ta stimuluar zhvillimin e sektorit privat në Kosovë, në veçanti për zhvillimin e ndërmarrësisë përmes projekteve të ndryshme. Shembull konkret për këtë kemi programin e COSME-s që ka për synim zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme", ka thënë ministri Shala.



Ai ka bërë me dije se programi në fjalë është një mundësi e mirë për ta promovuar ndërmarrësinë dhe për ta përmirësuar ambientin afarist për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme. "Në cilësinë e ministrit të Tregtisë dhe Industrisë ju siguroj që prioritet kemi zhvillimin e kapaciteteve ekonomike në Kosovë. E keni përkrahjen e plotë nga ana jonë. Do t'u

mundësojmë bizneseve ta realizojnë potencialin e tyre të plotë si brenda ekonomisë vendore, po ashtu edhe në ekonominë ndërkombëtare. KIESA si Agjenci për Investime dhe Përkrahje të Ndërmarrjeve në Kosovë, në kuadër të aktiviteteve të veta, ka edhe programin COSME, për të cilin program pague obligimet financiare vjetore në nivel ndërkombëtar dhe

njofton komunitetin e biznesit për mundësitë e përfuturit nga programi COSME", ka theksuar Shala.

Ai ka thënë se MTI-ja në mënyrë të vazhdueshme po punon që Kosova të bëhet vend ideal për të bërë biznes. "Ne në MTI në mënyrë të vazhdueshme jemi duke punuar që Kosovën ta bëjmë vend ideal për të bërë biznes. Njëkohësisht, zhvillimi i

potencialit të prodhimitarisë vendore mbetet fokusi ynë, gjithmonë duke u siguruar që kemi konkurrencë të drejtë dhe të barabartë në treg. Në kuadër të mandatit të Agjencisë për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë ofrojmë programe mbështetëse për ndërmarrësit në Kosovë duke filluar nga subvencionimi i makinerive prodhuese, skemat për certifikim të produkteve, skemat për këshillim, bashkëpunim me bizneset dhe gjetje të tregjeve të huaja etj. Njëkohësisht, vlen të ceket roli i Fondit Kosovor për Garanci Kreditore i cili ka garantuar mbi 1 mijë kredi në vlerë afër 52 milionë euro, në gjysmën e parë të këtij viti, për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme. Këto kredi nuk do të lëshoheshin pa garancinë e Fondit Kosovor", është shprehur ministri Shala. Sipas tij, Programi i COSME-s është edhe një mundësi më e madhe për t'u mundësuar ndërmarrjeve dhe ndërmarrësve të rinj për t'u zhvilluar edhe më tutje. "Të përdoren fondet si COSME dhe të ngjashme për të shtuar edhe më tutje qasjen në tregje ndërkombëtare dhe rajonale", ka deklaruar ministri Shala.

Rekord në aeroportin 'Adem Jashari', shpërblehet udhëtari i dymiliontë

EPOKA E RE A. MAVRAJ

PRISHTINË, 3 DHJETOR - Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës "Adem Jashari" ka arritur të hënën shifër rekorde duke shërbyer udhëtarin e dymiliontë të këtij viti. Rekordi i arritur është shoqëruar me një ceremoni solemne të mbajtur në terminalin e ANP "Adem Jashari", me ç'rast është shpërbleyer udhëtari i dymiliontë, me një biletë kthyesë dhe kartelë CIP. Kjo shifër është arritur për herë të parë brenda një viti qysh nga fillimi i funksionimit të Aeroportit të Prishtinës dhe vjen si rezultat i angazhimit të vazhdueshëm të kompanisë Limak për krijimin e



lehtësirave ndaj kompanive ajrore, për mundësimin e infrastrukturës më të avancuar si dhe

të shërbimeve shtesë të aeroportit, me qëllim të përhershëm për mbajtjen e kënaqshmërisë së

udhëtarëve në nivelet më larta. "Numri i udhëtarëve tanë po rritet në vazhdimësi, në të njëjtën kohë po mbajmë kënaqshmërinë e klientëve tanë në nivelet më të larta. Këto rezultate dëshmojnë se Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës është një nga projektet më të suksesshme të privatizimit në Evropë", ka thënë Gokmen Aritay, drejtor i operimeve në Limak Kosovo International Airport JSC. Deri në fund të vitit pritet që ANP "Adem Jashari" ta frekuentojnë mbi 2 milionë e 150 mijë udhëtarë. Shtimi i shumë linjave të reja ka ndikuar në rritjen e shpejtë të numrit të udhëtarëve gjatë viteve të fundit. Në anën

tjetër, linjat e reja të parapara si dhe stacionimi i kompanisë ajrore "Germania" në Aeroportin e Prishtinës gjatë vitit të ardhshëm pritet të ndikojnë dukshëm në vazhdimin e këtij trendi të rritjes.

Duke i uruar krerët e ANP "Adem Jashari" dhe pasagjerët, ministri Lekaj ka thënë se ky aeroport tashmë ka dëshmuar cilësi dhe siguri në udhëtime, ndërsa performanca do të ngrihet edhe shumë me zgjerimin e pistës së saj, në të cilën po punohet aktualisht. Lekaj, po ashtu, ka thënë se Ministria e Infrastrukturës, por edhe Qeveria e Kosovës, do të jenë përkrahëse të fuqishme të ANP-së.

Prezantohen variantet e "Autostradës së Dukagjinit"

PRISHTINË, 3 DHJETOR (ER) - Komiteti Ndërmintor për Autostradën që do të lidhë pesë komuna, Istog-Pejë-Deçan-Gjakovë-Prizren, mbajti takimin e vet të radhës, me ç'rast para anëtarëve të këtij komiteti u prezantuan tri variantet e mundshme se nga do të shtrihet traseja e kësaj autostrade.

Ministri Pal Lekaj i ka informuar anëtarët e komitetit se pas konsultimeve publike në komunat përkatëse do të përcaktohet se me cilin variant do të shkohet tutje. Varianti i parë ka gjatësi rreth 90 kilometra, i dyti 94 kilometra dhe i treta rreth 96 kilometra. Autostrada e Dukagjinit parashihet të fillojë nga Burgu i

Dubravës, kalon nëpër Istog, Pejë, Deçan, Gjakovë dhe i afrohet Rahovecit e Malishevës që të ketë qasje në kyçjen kryesore në autostradën për Prizren. Për të tre variantet janë zgjedhur korridore që kanë kosto më të ulët për Qeverinë e Kosovës, pa i cenuar parametrat teknikë të autostradës, e cila do të jetë e tipit të mbyllur.



Në 'Prishtina 2018' bëhet thirrje të mos ngrehen çmimet



**EPOKA
ERE** **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 3 DHJETOR - Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka marrë pjesë të hënën në hapjen e edicionit të 17 të Panairit të Produkteve Bujqësore, Agroindustriale dhe Tregtisë Inverse "Prishtina 2018", organizuar nga Oda Ekonomike e Kosovës, fokusi i të cilit është promovimi i produkteve të Kosovës nga kompani të ndryshme, prej të cilave 36 kompani nga Kosova dhe një nga Italia.

Kryeministri Haradinaj, me këtë rast, ka thënë se është këtu për ta

inkurajuar krijimin e lidhjeve biznesore në mes të ndërmarrjeve të mëdha, të mesme, por edhe të vogla, për t'i promovuar produktet vendore. "Qëllimi ynë është zvogëlimi i importit ose zëvendësimi i produkteve nga importi në produkte të prodhim-it vendor", ka thënë kryeministri Haradinaj, duke shtuar se me implementimin e politikave të reja fiskale të Qeverisë së Kosovës është inkurajuar rritja e ndërmarrjeve të sektorit të prodhimit dhe të sektorit të informacionit.

Kryeministri Haradinaj ka thënë se taksat e vendosur prej 100 përqindësh për produktet serbe

dhe atyre të Bosnjës nuk duhet të shihet si rast për të përfituar nga ngritja e çmimeve, por për ta rritur prodhimin dhe cilësinë. "Edhe pse ende në fillim, taksat ka ndikuar në rritjen e prodhimit vendor", është shprehur kryeministri Haradinaj. Ai ka shtuar se këto zhvillime duhet të sjellin edhe rritjen e brutoproduktit vendor, rritjen e numrit të të punësuarve, njëkohësisht kompensohet tatimi që e humb buxheti i Kosovës me zvogëlimin e importit nga Serbia dhe Bosnja. Kryeministri Haradinaj ka thënë se Qeveria e Kosovës është e përkushtuar për përmbushjen e obligimeve ndaj CEFTA-s, por

vetëm si palë e barabartë dhe ndihet i lumtur që Qeveria ka përmbushur obligimet e saj që ndërlidhen me protokollin e 5 të CEFTA-s dhe ka reflektuar pozitivisht marrëveshjen që ndërlidhet me protokollin 6.

Ministri i Tregtisë dhe Industrisë, Endrit Shala, ka thënë se ministria që drejton do ta mbështetë gjithmonë zhvillimin e bizneseve vendore përmes mekanizmave që ka. "Ju siguroj se gjithnjë do ta keni mbështetjen time si ministër në funksion të avancimit të prodhuesit kosovar. Ejani ta duam të gjithë tonën", ka thënë ministri Shala.

Ndërkaq kryetari i Odës

Ekonomike të Kosovës, Berat Rukiqi, ka thënë se kjo ditë e ka një rëndësi të veçantë për shkak të një momentumit të ri që është krijuar, ku ka një ngritje të vetëdijes për potencialin e ekonomisë sonë dhe se këto ditë do ta shfaqin potencialin e ekonomisë që është zhvilluar me shumë mund.

Një fjalë rasti në këtë panair mbajti edhe ministri i Tregtisë dhe Industrisë, Endrit Shala, ndërsa të pranishëm ishin edhe ministri i Inovacionit dhe Ndërmarrjes, Besim Beqaj dhe ambasadori i Republikës së Shqipërisë në Kosovë, Qemal Minxhozi.

ATK-ja pezullon nga detyra dy inspektorë tatimorë

Prishtinë, 3 dhjetor (ER) - Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) ka njoftuar se ka pezulluar nga marrëdhënia e punës dy inspektorë tatimorë të cilët janë arrestuar nën dyshimin se kanë keqpërdorur pozitën dhe autoritetin zyrtar. Të pezulluarit nga marrëdhënia e punës janë një

inspektor tatimor si dhe një inspektore e lojërave të fatit. "Menaxhmenti i ATK-së siguron opinionin se çdo informatë e dëshmuar për keqpërdorim të detyrës zyrtare dhe rasteve korruptive do të dërgohet në organet kompetente për trajtim dhe ndaj të gjithëve që shpallen fajtorë

për vepra penale do të ndërmerren masat e largimit nga marrëdhënia e punës në institucionin tonë. ATK-ja falënderon qytetarët, mediat, Prokurorinë dhe Policinë e Kosovës për mbështetjen në luftimin e dukurive negative", është thënë në njoftimin për media.



Katër aktakuza për dhunë në familje gjatë muajit nëntor në Gjakovë

GJAKOVË, 3 DHJETOR (ER) - Prokuroria Themelore në Gjakovë gjatë muajit nëntor ka pranuar pesë raste të cilësuar si dhunë në familje, përkatësisht vepra penale nga neni 188/3 të KPK-së. Për të gjitha rastet është marrë aktvendim për fillimin e hetimeve dhe është caktuar masa e paraburgimit ndaj të

gjithë të pandehurve, ndërkaq ndaj tyre është duke u zhvilluar procedura hetimore. Gjithashtu, gjatë muajit nëntor nga e njëjta prokurori janë ngritur katër aktakuza dhe një propozim për trajtim të detyrueshëm psikiatrik, për rastet e dhunës në familje, nga neni 188/3 i KPK-së.



Komuna e Mitrovicës vazhdon ta mbështesë HANDIKOS-in

MITROVICË, 3 DHJETOR (ER) - Në kuadër të shënimit të Ditës Ndërkombëtare të Personave me Aftësi të Kufizuar, nënkryetari i komunës, Faruk Mujka, i shoqëruar nga drejtori i Arsimit, Iset Beka, drejtori i Administratës, Hysen Muzliukaj dhe koordinatori i Njësisë për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut, Fitim Rama, të hënën kanë vizituar OJQ "HANDIKOS", me ç'rast janë pritur nga drejtuesja e HANDIKOS-it, Myrvete Hasani. Qëllimi i këtij takimi ishte që të njihen më shumë me gjendjen

aktuale të kësaj kategorie të qytetarëve dhe kushtet me të cilat vepron HANDIKOS-i në Mitrovicë. Drejtuesja e HANDIKOS-it, Myrvete Hasani, ka falënderuar përfaqësuesit komunalë për vizitën dhe interesimin e tyre, duke thënë se tani organizata e tyre ka gjithsej 550 persona me aftësi të kufizuar, prej të cilëve 150 janë fëmijë, që jetojnë në kushte jo të mira dhe presin që në të ardhmen kjo gjendje të ndryshojë. "Ne jemi të vetëdijshëm se komuna ka vështirësi të mëdha për funksionimin e saj për shkak

të buxhetit të pamjaftueshëm dhe gjendjes së rëndë në të cilën jetojnë një numër i madh familjesh. Mirëpo, edhe përkundër kësaj gjendje, ju nënkryetar keni treguar vullnet dhe keni gjetur mundësi që të na ndihmoni dhe të na mundësoni që disa prej aktiviteteve tona t'i realizojmë. Mirëpo, megjithëkëtë, në mungesë të mjeteve, nuk kemi realizuar edhe shumë aktivitete të domosdoshme për anëtarësinë tonë. Sidoqoftë, ne ju jemi shumë mirënjohës për mbështetjen e madhe që po na e jepnin", ka thënë Hasani.



Hoti dhe Muhaxheri nënshkruajnë marrëveshje për të rinjtë e Pejës

PEJË, 3 DHJETOR (ER) - Rexhep Hoti, koordinator Nacional për Kulturë, Rini dhe Sport në Qeverinë e Kosovës, ka nënshkruar të hënën marrëveshje bashkëpunimi me kryetarin e Komunës së Pejës, Gazmend Muhaxheri, për implementimin e Programit Nacional për Rininë për të gjithë nxënësit dhe studentët e kësaj komune. "Programi Nacional

për Rininë është hartuar për secilin nxënë të secilës shkolle, duke filluar nga niveli filior, i mesëm i ulët dhe niveli i mesëm i lartë. Ky program parasheh përfshirjen e të gjithë nxënësve dhe studentëve në garë. Pres që të gjithë ata të përfitojnë nga ky program", u shpreh koordinatori Hoti. Ndërsa kryetari Muhaxheri ka

theksuar se do ta mbështesë Programin Nacional për Rininë sepse do t'i ndihmojë Pejës, veçanërisht në sport. "Përmes këtij programi do ta finalizojmë projektin e futjes së sportit nëpër shkolla. Ne kemi ndërtuar shtegun e atletikës që në raport me programin do ta mundësojë zhvillimin e garave në atletikë", ka thënë Muhaxheri.

15 raste të dhunës në familje në Ferizaj në muajin nëntor

Ferizaj, 3 dhjetor (ER) - Prokuroria Themelore në Ferizaj gjatë muajit nëntor ka pranuar pesëmbëdhjetë lëndë të cilësuar si dhunë në familje, me gjithsej pesëmbëdhjetë persona, ku dymbëdhjetë prej tyre janë femra dhe tre meshkuj. Gjithashtu, gjatë

muajit nëntor Prokuroria Themelore në Ferizaj ka ngritur pesë aktakuza dhe ka caktuar masë për paraburgim për rastet e dhunës në familje, gjegjësisht për veprat penale "Lëndim i lehtë trupor", "Sulm" dhe "Kanosje" të bazë të KPRK-së.



Në Kosovë shënohet Dita Ndërkombëtare e Personave me Nevoja të Veçanta

"Shoqëria jonë nuk mund të mburret me zhvillimin nëse personave me nevoja të veçanta nuk ua ka dhënë kujdesin e duhur dhe trajtimin e barabartë", kështu ka thënë kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, pasi ka pritur në takim disa studentë me nevoja të veçanta. Ministri i Arsimit, i Shkencës dhe i Teknologjisë, Shyqiri Bytyqi, ka thënë se shënimi i kësaj dite të veçantë nënkupton kujdesin që duhet ta kemi në vazhdimësi për personat me nevoja të veçanta



Nevoja të Veçanta, të organizuar nga Qendra Burimore "Nënë Tereza" në Mitrovicë. Ministri Bytyqi ka thënë se shënimi i kësaj dite të veçantë nënkupton

kujdesin që duhet ta kemi në vazhdimësi për personat me nevoja të veçanta, në veçanti të kujdesemi për edukimin dhe arsimimin e tyre.

Bytyqi ka theksuar se ka sfida kur flitet për arsimimin e personave me nevoja të veçanta, por ka thënë se po punojnë dhe e kanë obligim t'i kalojmë sfidat në këtë drejtim. "Kjo kategori në asnjë mënyrë nuk guxon të quhet e marginalizuar në shoqërinë tonë, por duhet të jetë e barabartë dhe e integruar në shoqëri", është shprehur ministri Bytyqi, duke theksuar se 3 dhjetori është ditë e veçantë që ka për qëllim ta vetëdijesojë tërë shoqërinë që të ketë përgjegjësi të përditshme ndaj kësaj kategorie. "Ne e kemi obligim që çdo ditë të punojmë për këtë komunitet, për të krijuar kushte për ta arsimuar dhe në këtë mënyrë të bëjmë të mundur që të ndihet i barabartë në shoqërinë tonë", ka deklaruar ministri Bytyqi, ndërsa

ka falënderuar mesimdhënësit e Qendrës Burimore "Nënë Tereza" në Mitrovicë për punën që po bëjnë me fëmijët me nevoja të veçanta.

Ministri ka theksuar se MASHT-i tashmë e ka përgatitur infrastrukturën ligjore e cila jep mundësi dhe obligon institucionet politikëbërëse dhe arsimore të krijojnë kushte dhe të kujdesen për edukimin dhe arsimimin e fëmijëve me nevoja të veçanta, në mënyrë që ata të aftësohen për t'u kujdesur për veten dhe të jenë të dobishëm për shoqërinë.

Ministri Bytyqi ka vizituar ambientet e Qendrës dhe ka parë edhe ekspozitën e përgatitur nga nxënësit. Në vitin 1992 Asambleja e Kombeve të Bashkuara 3 dhjetorin e përcaktoi ditë Ndërkombëtare të Personave me Nevoja të Veçanta, e cila ka për qëllim ta ngrehë vetëdijen shoqërore në gjithë botën për kujdesin që duhet të kemi ndaj kësaj kategorie.

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 3 DHJETOR - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, ka pritur të hënën në takim disa studentë me nevoja të veçanta. Në ditën ndërkombëtare të tyre, Veseli me studentët nga kjo kategori kanë diskutuar për sfidat dhe nevojat që ata kanë. "Shoqëria jonë nuk mund të mburret me zhvillimin e saj nëse personave me nevoja të veçanta nuk ua ka dhënë

kujdesin e duhur dhe trajtimin e barabartë. Sot, në ditën ndërkombëtare të tyre, me studentët nga kjo kategori diskutuam për sfidat dhe nevojat që ata kanë. E tashmja dhe e ardhmja e vendit është përgjegjësi e secilit prej nesh dhe vetëm puna e përbashkët e zhvillon edhe më shumë atë", ka thënë Veseli.

Ndërkaq ministri i Arsimit, i Shkencës dhe i Teknologjisë, Shyqiri Bytyqi, ka marrë pjesë në ceremoninë e shënimit të Ditës Ndërkombëtare të Personave me



Nga 15 dhjetori nuk do të ketë më reduktime të energjisë elektrike

PRISHTINË, 3 DHJETOR (ER) - Kryeministri Ramush Haradinaj, bashkë me ministrin e Zhvillimit Ekonomik, Valdrin Lluka dhe zëvendësministrin e Financave, Fatmir Gashi, kanë zhvilluar të hënën një takim pune me përfaqësuesit e KEK-ut, ZRRE-së, KEDS-it dhe KOSTT, me të cilët ka diskutuar për situatën energjetike në vend dhe për zhvillimet në ditët e fundit.

Kryeministri ka shprehur shqetësimin për situatën energjetike në ditët e fundit dhe ka kërkuar mobilizim maksimal të të gjithë aktorëve përgjegjës për stabilitet të furnizimit me energji elektrike të amvisërive

dhe bizneseve në Kosovë. "Qeveria e Kosovës ka qenë e përkushtuar dhe e angazhuar të krijojë ambientin dhe kushtet e përshtatshme për prodhimin dhe furnizimin me energji elektrike në Kosovë, që në fillim duke e zgjidhur problemin e shpronësimeve dhe tani me plot përgjegjësi dhe kompetencë kërkon që edhe aktorët e tjerë t'i përmbushin obligimet e tyre dhe për Kosovën të mos jetë më problem furnizimi me energji elektrike", ka thënë kryeministri Haradinaj.

Haradinaj ka kërkuar nga përfaqësuesit e institucioneve përkatëse që të krijohet një



mekanizëm për t'iu qasur këtij problemi që të mos ketë më raste të ndërprerjeve me orë të tëra. Në veçanti është theksuar se sezoni i dimrit i rritë kërkesat dhe kërkon angazhim maksimal për të siguruar furnizim të rregullt dhe të mjaftueshëm për të gjithë me energji elektrike. Në këtë takim u sigurua që me rikthimin në funksion të Bllokut B1 nga 15 dhjetori i këtij viti do të ketë stabilizim të furnizimit me energji elektrike.

Kryeministri Haradinaj ka kërkuar nga përfaqësuesit e institucioneve të bashkëpunojnë ndërmjet vete, të komunikojnë dhe bashkëveprojnë për të mirën e qytetarëve.

LAMTUMIRË PRESIDENT I AMERIKËS



Ismet SYLEJMANI

Mbylli sytë përgjithmonë
Presidenti i ShBA-së George
H.W. Bush
Presidenti i ShBA-së George H.
W. Bush
Babai i presidentit të ShBA-së
George H.W. Bush

Vdekja është tragjedi, pasi ajo
merr edhe emra të mëdhenj e
të dëgjuar që i kanë shërbyer
njerëzimit dhe që kanë luajtur
rol vendimtarë për mbarëvajt-
jen dhe funksionimit normal e
të domosdoshëm të raporteve
në mes kontinenteve, shteteve
dhe popujve e kombeve.

Lajm i kobshëm!

Presidenti i presidentit të
ShBA-së, George H.W. Bush, ka
vdekur, ka mbyllur sytë
përgjithmonë.

Është ndarë nga jeta presidenti
i ShBA-së, George H.W. Bush,
babai i presidentit të ShBA-së,
George W. Bush.

Ka ndërruar jetë personaliteti i
madh politik, njeriu i parë,
presidenti i ShBA-së George
H.W. Bush, të cilin populli
shqiptar e ka pasur për fat ta
kishte pas presidentit
Woodrow Wilson, të dytin presi-
dent amerikan që mban qëndrim
ndaj çështjes shqiptare të
pazgjidhur të Kosovës e vise të
saja në ish-Jugosllavi, qëndrim
shumë madhor, përkrahës e
miqësor George H.W. Bush.

Ka pushuar së rrahuri zemra e
George H.W. Bush, i cili pas
qëndrimit të njohur pro çësht-
jes shqiptare të presidentit
Woodrow Wilson, ishte i pari
që mbajti qëndrimin më të
madh pro Kosovës dhe zgjid-
hjes së drejtë të sajë.

Presidenti Bush për herë të
parë i vuri kufi kriminelit e
gjakpirësit Milloseviq në
raport me Kosovën.

Bush kërcënon Milloseviqin

Washington (AFP) / Sipas New
York Times presidenti George
H.W. Bush i dërgoi një letër
presidentit të Serbisë,
Slobodan Milloseviq javën e
kaluar duke u këshilluar mes


liderëve serbë se 'në rast të
konfliktit në Kosovë të shkak-
tuar nga veprimi serb, Shtetet e
Bashkuara do të jenë të përgat-
itura të përdorin forcën
ushtarake kundër serbëve në
Kosovë dhe në Serbi "As
Shtëpia e Bardhë dhe as
Departamenti i Shtetit nuk do
të komentonin mbi raportin.
Zëdhënësi i departamentit tha
se ShBA ishte "thellësisht e
shqetësuar për situatën në
Kosovë".

Bombardimet e Serbisë
pushtuese të vitit 1999 nga
NATO-ja dhe roli i madh e his-
torik i presidentit të ShBA-së
Bill Clinton dhe kryeministrit
të Britanisë së Madhe Tony
Blair, por edhe më 2007-n qënd-
rimi historik në Tiranë për
Pavarësinë e Kosovës i presi-
dentit të ShBA-së George W.
Bush, ishin në vijën e zbatimit
të saktë të qëndrimit të madh
pro shqiptar të Shefit të CIA-s
dhe presidentit të ShBA-së,
mikut të madh të popullit
shqiptar dhe të paharruarit e të
pavdekshmit George H.W.
Bush.

Populli shqiptar i Kosovës dhe
viseve të saja dhe gjeneratat që
do të vijnë, i përgjithmonë
me respektin më të
madh qëndrimit e kontributit
historik në vitin 1992 të presi-
dentit të ShBA-ve kundër
Serbisë e kundër politikës
shfarosëse e asimiluese të
kryekriminelit e gjakpirësit
famëkeq Milloseviq!

Populli shqiptar në Kosovë
duhet të shpallë ditë zie kom-
bëtare me rastin e ndarjes nga
jeta të presidentit të ShBA-ve
George H.W. Bush.

Parlamenti i Kosovës duhet të
mbaje senacë speciale komem-



INDEPENDENT

NEWS POLITICS VOICES FINAL SAY SPORT CULTURE VIDEO INDY/LIFE INDYBEST LONG READS INDY100

Bush threat to Milosevic

Tuesday 29 December 1992 01:02 | 0 comments

WASHINGTON (AFP) - According to the New York Times, President George Bush sent a message to the Serbian President, Slobodan Milosevic, last week cautioning Serbian leaders that 'in the event of conflict in Kosovo caused by Serbian action, the United States will be prepared to employ military force against the Serbs in Kosovo and in Serbia proper'.

Neither the White House nor the State Department would comment on the report. The department spokesman said the US was 'deeply concerned about the situation in Kosovo'.

MORE ABOUT **GEORGE W. BUSH** **SERBIA** **USA**

orative me rastin e ndarjes nga
jeta të ish-presidentit të ShBA-
ve George H.W. Bush.

Populli shqiptar në Kosovë në
të ardhmen duhet ta ketë një
shtatore të ish-presidentit tash-
më të ndjerë të ShBA-ve,
George H.W. Bush dhe djalit të
tij, vulosësit ndërkombëtar të
Pavarësisë së Kosovës në Tiranë
më 2007, presidentit të ShBA-
ve George W. Bush! Presidentët
Bush dhe familja Bush, ashtu
sikur edhe presidentët
Woodrow Wilson dhe Bil
Clinton e kryeministri anglez
Tony Blair, janë e do të jenë
përgjithmonë sa të ketë shqiptar
mbi dhe, miq e aleatë të përjet-
shëm të popullit shqiptar.
Populli shqiptar sot dhe brezat
që do të vijnë do të përgjithmonë
me respekt e në jetë të jetëve në
nderim dhe kujtim të tyre!

Prishtinë, 2 dhjetor 2018

E rrallë

Ngordhin 200 balena brenda një jave

51 balena kanë ngordhur pasi u bllokuan në një plazh në ishujt Chatham në Zelandën e Re. Bllokimi ka bërë që më shumë se 200 balena të ngordhin në incidente të ndara gjatë javës së kaluar në rajon. Zyrtarët e Zelandës së Re thonë se 80 deri në 90 balena



u gjetën të bllokuara në gjirin Hanson të enjten.

FOTO E DITES



Disa policë të Francës shihen të mbuluar me ngjyrë gjatë protestave në Paris kundër rritjes së çmimeve të naftës. /AFP/

E jashtëzakonshme

Hondurasi prodhon filxhanin më të madh të kafesë në botë

Hondurasi ka prodhuar filxhanin më të madh të kafesë në botë. Ky filxhan mund të mbajë rreth 18 000 litra kafe. Rekordi i mëparshëm mbahej nga Mbretëria e Bashkuar, me një filxhan prej 13 200 litrash. Filxhani i Hondurasit është bërë prej çeliku dhe me një shtresë izolimi plastike. Filxhani ka një



cilindër të jashtëm prej hekuri me një fund të bardhë, që i jep një pamje qeramike.

BARSOLETA E DITËS



Vajza: Shpirt, më duket vetja shumë e shëndoshë, e shëmtuar dhe e plakur.
Të lutem, më bëj një kompliment.
Djali: Zemër, ke shikim shumë të mirë.




Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

“ALPHA” 3D,

Aventure/Drame/Familjar; 1 ore 36 min

Rolet: Kodi Smit-McPhee, Jóhannes Haukur Jóhannesson
Regjia: Albert Hughes

Vetëm gjatë vikendit në ora 14:00



Në ora 16:00

“JOHNNY ENGLISH STRIKES AGAIN”

Aksion/Aventure/Komedi; 1 ore 28 min

Rolet: Rowan Atkinson, Olga Kurylenko, Emma Thompson, Ben Miller, Miranda Hennesy, Jake Lacy, etj.
Regjia: David Kerr



Në ora 18:00

“NIGHT SCHOOL”

Komedi; 1 ore 51 min

Rolet: Kevin Hart, Tiffany Haddish, Rob Riggle, Taran Killam, Romany Malco, etj.
Regjia: Malcolm D. Lee



Në ora 20:00

“SIBERIA”,

Komedi; 1 ore 51 min

Rolet: Keanu Reeves, Ana Ularu, Pasha D. Lynchnikoff, James Gracie, Eugene Lipinski, Rafael Petardi, Veronica Ferres, Molly Ringwald, etj.
Regjia: Matthew Ross



Në ora 22:00

“VENOM” 3D,

Aksion/Horror/Fantastiko-Shkencor; 1 ore 52 min

Rolet: Tom Hardy, Michelle Williams, Riz Ahmed, Scott Haze, Reid Scott, etj.
Regjia: Ruben Fleischer
Based on the Marvel Comics



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.



DASHI

Komunikimi i mirë është ai që do të lejojë të


ecësh ose jo në karrierë. Çdo gjë varet sot në mënyrën se si do t'i menaxhoni kontaktet tuaja.



DEMI

Keni nevojë për meditim sot dhe doni të rini të

izoluar larg zhurmës. Po mendoni për një vend ideal ku mund ta qetësoni shpirtin dhe mendjen.



BINJAKËT

Sot fusha e privilegjuar e jetës suaj

është miqësia. Në çdo çast do t'u përkushtoheni miqve tuaj për t'u treguar se sa vlerë kanë për ju.



GAFORRJA

Jo vetëm do të ëndëroni sot, por do të

bëni realitet një udhëtim të këndshëm. Prenotoni tani një udhëtim të shkurtër.



LUANI

Shumë flirte parashikohen sot për ju

dhe një natë pasioni mbase me një person të huaj. Kryqëzoni gishtat për të ardhmen.



IRGJËRESHA

Mbani nën fre fantazitë tuaja sot sepse

mund të ikni shumë larg realitetit. Kjo gjë do t'ju dëmtojë disi sepse nuk do të jeni të vëmendshëm gjatë ditës.



PESHORJA

Dita juaj do të varet sot nga humori që do të

zgjoheni. Nëse jeni optimist çdo gjë do të shkojë më së miri.



AKREPI

Jeni mjaft ekspresiv dhe

kreativiteti juaj vërehet ngado si në çështjet që kanë të bëjnë me punë, edhe në ato familjare.



SHIGJETARI

Nuk jeni shumë i kthjellët në gjykime sot

dhe kjo ka të bëjë me një ndjenjë paragjykimi që keni për një person të caktuar.



BRICJAPI

Jeni disi të ndrojtur për shprehjen e

mendimeve tuaja, por sot duhet të jeni ju ai që vendosni për mbarëvajtjen e një projekti të caktuar.



UJORI

Sot do të jetë e thjeshtë të flisni për

dashurinë dhe të shkëmbeni energji pozitive me partnerin. Dita do të vazhdojë e qetë dhe e këndshme.



PESHQIT

Sot jeni të përfshirë në ndjenja dhe emo-

cione të thella karshi një personi të caktuar. Nuk po i kushtoni rëndësi asnjë gjëje rreth jush.


Emily Ratajkowski kthehet nga pushimet në Moroccan



Modeluesja Emily Ratajkowski është kthyer nga pushimet që ishte së bashku me bashkëshortin Sebastian Bear-McClard. Çifti

ishte në pushime në Moroccan të Afrikës së Veriut. Ndërsa këtë fundjavë ajo u pa tekta shëtiste rrugëve të Nju Jorkut së bashku me prindërit.

Halsey kritikon 'Victoria's Secret'



Halsey mendoi se performanca e saj në kuadër të organizimit të "Victoria's Secret Fashion Show" të vitit 2018 do të jetë gjëja më e mirë e këtij viti. Mirëpo komentet e fundit transfobike ia kanë ndryshuar

mendjen. Këngëtarja u shpreh e dëshpëruar dhe nevrrike përmes një shkrimi në "Instagram". Ajo vlerësoi se ky shou ka mungesë të gjithëpërfshirjes, duke iu referuar transgjinjorëve, me të cilët ajo tha se bazohen në stereotipa.



Lucy Hale duket e mrekullueshme edhe në palestër

Aktorja Lucy Hale është e njohur për dukjen interesante në qilimin e kuq por, si duket, veshjet e bukura të saj nuk kanë të ndalur as në palestër. 29-vjeçarja pati të veshura tuta

ngjyrë hiri të shoqëruar me një bluzë të gjelbër dhe xhakëtë lëkure. Ajo u pa të shtunën tekta dilte nga palestra në Los Angeles. Aktorja, si duket, pas palestrës pëlqen të pijë kafe.

Bella Hadidi shfaqet me flokë ngjyrë rozë në Tokio



Bella Hadidi është shfaqur me flokë të kuqe në shfaqjen e saj të radhës për Dior në Tokio. Modeluesja shkoi në kryeqytetin japonez në shfaqjen e Dior Homme. Është e paqartë nëse Hadidi ka

ngjyrosur flokët me ngjyrë rozë apo ka i vendosur ato. Javën e kaluar Hadidi ishte në Abu Dhabi, ku bashkë me të dashurin e saj, The Weeknd, bënë një udhëtim nëpër shkretëtirë dhe morën me qira një veturë luksoze.

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN
SEKURIT
PILKINGTON
Enveri

Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com

Sport

QENDRA SPORTIVE

"BUJQËSIA"

TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE

BOURNEMOUTH - HUDDERSFIELD

1

BRIGHTON - CRYSTAL PALACE

GG

WEST HAM - CARDIFF

1

Feronikeli i dyti, Hoxha: Sezon pozitiv

Pavarësisht se Feronikeli përfundoi i dyti në sezonin vjeshtor, futbollisti Yll Hoxha e ka vlerësuar pozitivisht skuadrën nga Drenasi. "Stinorin vjeshtor e shoh pozitiv për skuadrën tonë. Normalisht se kampionati ka edhe të papritura por, duke marrë parasysh të gjitha aspektet, mund të them se kemi qenë të mirë në këtë sezon", ka thënë Hoxha



EPOKA E RE

Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 3 DHJETOR - KF Feronikeli në afatin kalimtar të verës bëri një organizim të jashtëzakonshëm, duke bërë edhe transferime të mëdha, kurse me kalimin e xhrove ndryshoi edhe trajnerin. Në vend të Sulejman Starovës e rikthej Zekirija Ramadanin, por sezonin vjeshtor kjo skuadër e mbylli në vend të dytë me një pikë më pak se Prishtina.

Futbollisti Yll Hoxha, një ditë pasi është mbyllur sezoni vjeshtor, ka thënë për "Epokën e re" se rezultatet e skuadrës nga Drenasi kanë qenë pozitive. Ai nuk beson se humbja nga Prishtina ka qenë vendimtare që Feronikeli mos të shpallet kampion

vjeshtor. "Stinorin vjeshtor e shoh pozitiv për skuadrën tonë. Normalisht se kampionati ka edhe të papritura, por duke marrë parasysh të gjitha aspektet, mund të them se kemi qenë të mirë në këtë sezon. Nuk besoj se ka qenë vendimtare humbja nga Prishtina, sepse aty kanë qenë në pyetje vetëm tri pikë si në gjithë ndeshjet e tjera", ka thënë Hoxha.

Pesë pikë është diferenca në mes tri skuadrave të para: Prishtinës (40 pikë), Feronikelit (39) dhe Llapit (35). Yll Hoxha ka thënë se vetëm tri skuadrat e para që janë pas sezonit vjeshtor do të luftojnë për titull deri në fund të kampionatit, duke e përjashtuar nga gara edhe kampionen aktuale, Dritën. "Mendoj se tri skuadrat e para që prijnë në tabelën e Superligës do të jenë në

garë për titull deri në fund të kampionatit", ka shtuar ai.

Futbollisti që dikur ka luajtur edhe për Hysin dhe Prishtinën, Yll Hoxha, në të kaluarën ishte pjesë e futbollit shqiptar. Ka luajtur për Kukësin, Flamurtarin e Vlorës dhe Vllazninë e Shkodrës. Por, do të djersijë fanellën e "Niklit" të paktën edhe për gjashtë muaj. "Jam pjesë e Feronikelit që dy vjet, kurse kam kontratë deri në fund të këtij kampionati. Shpresoj ta jap më të mirën nga vetja që klubi t'i arrijë synimet që ka në këtë edicion", ka përfunduar Hoxha.

Feronikeli në shtatëmbëdhjetë ndeshjet e zhvilluar arriti të regjistrojë 12 fitore, tri barazime dhe dy humbje. Ndërsa ka shënuar 29 gola dhe ka pranuar vetëm 9 gola.

SHKURT

Liga e Kombeve: Zvicër - Portugali, Holandë - Angli

Është hedhur shorti për ndeshjet gjysmëfinale të Ligës A të Ligës së Kombeve. Zvicra e shqiptarëve takohet me Portugalinë, ndërsa Holanda me Anglinë. Takimet do të luhen në Portugali. Gjysmëfinalja e parë do të mbahet më 5 qershor, ndërsa gjysmëfinalja e dytë një ditë më vonë, më 6 qershor. Dy kombëtares që arrijnë të shkojnë deri finale do të ndeshen mes vete më 9 qershor, për ta zbuluar se kush është kampioni i Ligës së Kombeve.

Përforcohet KB Ponte Prizreni

KB Ponte Prizreni ka paraqitur për regjistrim lojtarin ndërkombëtar Waller Christopher Doyle nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Lojtari i lartpërmendur mund të regjistrohet në Federatën e Basketbollit të Kosovës dhe të paraqitet për KB Ponte Prizreni pas plotësimit të kriterëve në bazë të rregullores mbi regjistrimin e lojtarëve në FBK.

Shaqiri: Jam i lumtur në Liverpool

Mesfushori shqiptar Xherdan Shaqiri edhe një herë e ka ripërsëritur se është i lumtur në skuadrën e Liverpoolit. "Jam shumë i lumtur që jam këtu. Jam ambientuar shumë mirë, njerëzit janë të sjellshëm, gjë që reflekton edhe në fushë. Po shikoj para, për një të ardhme të ndritur me këtë klub", ka thënë Shaqiri. Kohë më parë ishte folur se Shaqiri mund të largohej gjatë janarit nga Liverpooli dhe të transferohej në Turqi te skuadra e Galatasarayt.

MKRS-ja, 11 mijë euro për Federatën e Shahut

PRISHTINË, 3 DHJETOR - Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, ka nënshkruar një memorandum bashkëpunimi me kryetarin e Federatës së Shahut të Kosovës, Nysret Avdiu, me qëllim të mbështetjes financiare të FShK-së për blerjen e pajisjeve të shahut. Vlera e këtij

memorandumi është 11 mijë euro. "Ky memorandum u nënshkrua bazuar në kërkesën e Federatës së Shahut për blerjen e pajisjeve me qëllim të zbatimit të politikave të sportit të Republikës së Kosovës në pajtim me dispozitat e Ligjit për Sport dhe për realizimin e objektivave shtetërore të

ndërkombëtarizimit të sportit të përcaktuara nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit", ka thënë ministri Gashi, i cili ka premtuar mbështetje për këtë federatë me qëllim të avancimit të sportit të shahut dhe të krijimit të kushteve të favorshme për sportistët të cilët merren me këtë

sport. Ndërkaq kryetari i Federatës së Shahut të Kosovës, Nysret Avdiu, falënderoi ministrin Gashi. "Kjo mbështetje financiare ka rëndësi të madhe sepse ndikon shumë në lehtësimin e punës për të gjithë ata që merren me këtë sport", ka thënë Avdiu.



Kukësi paralajmëron rikthimin e Musollit

KUKËS, 3 DHJETOR - Skuadra e Kukësit, pa kaluar një javë që ndërpreu bashkëpunimin me mesfushorin nga Kosova, Besar Musollin, paralajmëron se ai mund të rikthehet sërish në

skuadrën ku ka dhënë kontribut të jashtëzakonshëm. "Musolli nuk është larguar përfundimisht nga Kukësi. Ai do të shkojë të rikuperohet në Kosovë dhe më pas, kur të jetë gati, mund të rik-

thehet në skuadër. Presidenti i ka thënë që kur të jetë rikuperuar, derën e ka të hapur. Musollit i përfundon kontrata në fund të sezonit, por besoj se Kukësi do të jetë sërish zgjedhja e tij e parë

dhe Besari do të jetë përsëri me ne. Ai është një prej lojtarëve më të vjetër në ekip dhe një prej elementëve më të rëndësishëm", ka thënë zëvendëstrajneri i Kukësit, Rahman Hallaçi.



Ujkani: Me Anglinë do jetë festë

TIRANË, 3 DHJETOR - Pas një edicioni mjaft të mirë në Ligën e Kombeve, Kosova do të marrë pjesë për herë të parë në eliminatoret e "Euro 2020", teksa goglat e çuan në grupin A, së bashku me Anglinë, Republikën Çeke, Bullgarinë dhe Malin e Zi. Kapiteni i "Dardanëve", Samir Ujkani, ishte i ftuar në lidhje të drejtpërdrejtë me emisionin "Zona Gol" në "Supersport", për të folur për shortin dhe ecurinë e Përfaqësueses së Kosovës dhe projektin e saj.

Sfidë ndaj Anglisë dhe pastaj dy derbi ballkanikë...

Ujkani: Është një grup shumë interesant, por duhet të pranojmë se jemi skuadra më e re dhe teorikisht më e dobëta në grup. Ne do të kërkojmë ta rritim nivelin sa më shumë, të fitojmë përvojë dhe të synojmë të konkurrojmë denjësisht. Jemi në një moment shumë të mirë dhe djemtë po kalojnë mirë, por duhet të bëjmë kujdes, pasi këtu është niveli shumë më i lartë.

Do ta nisni përvojën me Bullgarinë në Prishtinë dhe do ta mbyllni me Anglinë. Ju pëlqen ky kalendar?

Ujkani: Më vjen shumë mirë që ndeshjen e parë do ta luajmë në shtëpi, pasi e dimë se do të kemi një mbështetje shumë të ngrohtë nga publiku dhe kjo do të na ndihmojë të kemi një fillim pozitiv. Sfida e fundit me Anglinë jam i sigurt se do të



jetë madhështore, pasi besoj se do të jenë dhënë verdiktet.

Shorti ju ka dhënë edhe një herë kundërshtarë të fortë, ashtu si në eliminatoret e Botërorit...

Ujkani: Në fakt, është e vërtetë që niveli këtu është shumë i lartë dhe duhet angazhim shumë i madh. Besoj se me përvojën që kemi marrë në Ligën e Kombeve do të mund të paraqitemi më mirë këtë herë, në këto eliminatore.

Çfarë nënkuptoni, kur thoni se do të jetë festë me Anglinë? Mos ndoshta mendoni kualifikimi?

Ujkani: E mendoj si festë sepse po vjen një emër shumë i madh i futbollit botëror dhe kjo do të jetë një emocion i veçantë për të gjithë ne, ndonëse nuk e fsheh se do të më pëlqente ta luanim kualifikimin ndaj Anglisë, pavarësisht se do të jetë shumë e vështirë.

A mendoni se euforia mund të jetë armiku i Kosovës?

Ujkani: Po, patjetër. Është aspekti ku ne duhet të tregojmë më shumë kujdes. Duhet të rrimë me këmbë në tokë, pasi deri tani u përballëm me skuadra të një niveli të ulët, por tani kemi të tjerë kundërshtarë. Besoj se kemi djem të rinj, që po rriten në klubet e tyre dhe e kanë kuptuar se duhet qëndruar me këmbë në tokë dhe treguar respekt ndaj çdo kundërshtari.

Turqia dhe Islanda përballë Shqipërisë, skuadra që ju i njihni të dyja. Keni një koment për këto?

Ujkani: Janë dy skuadra shumë të forta, pasi ne jemi përballur me to, por mendoj se Shqipëria mund të konkurrojë me këto skuadra. Vetëm se duhet që publiku ta mbështesë Kombëtaren Shqiptare dhe të mos krijojë presion për rezultatet, pasi kjo është rruga për të shkuar te suksesi.

Lakersi mposhti Phoenixin

LOS ANGELES, 3 DHJETOR - Los Angeles Lakersi, falë liderit të saj LeBron Jamesi, mori fitoren e tretë radhazi dhe të 14-n në 23 takime, duke u ngjitur në vendin e pestë në Perëndim. Në fitoren e thjeshtë 120-96 ndaj Phoenix Sunsit, skuadrës më të dobët të konferencës, spikati dyshja Kuzma - James, respektivisht me 23 dhe 22 pikë. Vazhdon të fitojë Philadelphia 76ers që në shtëpi kaloi



103-95 Memphis Grizzliesin duke e blinduar vendin e tretë në Lindje

dhe duke kërcënuar nga pas Milwaukee Bucksin që pozicionohet i dyti. Në fitoren e 4-t rresht të 76ers, shkëlqeu dyshja J. J. Redick-Jimy Butler të cilët së bashku realizuan 45 pikë.

Rezultatet: Lakers-Phoenix (120-96), Charlotte-New Orleans (109-119), Miami-Utah Jazz (102-100), Philadelphia-Memphis (103-95), Dallas-Clippers (114-110), San Antonio-Portland (131-118).

Gjysmëfinalët dhe finalja e Ligës së Kombeve zhvillohen në Portugali

LSBONË, 3 DHJETOR - Portugalia edhe zyrtarisht është përcaktuar si organizatore e gjysmëfinalëve dhe finale të Ligës së Kombeve që do të mbahen në qershor. Kombëtarja e Portugalisë u bë skuadra e parë që u kualifikua në gjysmëfinalen e turneut inauguroes të UEFA-s dhe asaj iu bashkuan edhe Anglia, Zvicra dhe Holanda. Italia,

Portugalia dhe Polonia ishin në garë për organizimin e ndeshjeve gjysmëfinale dhe finale të kësaj gare, që të tri këto kombëtare në Grupin 3 të Ligës A, dhe UEFA kishte vendosur që cilado prej tyre të shpallet fituese e grupit, do ta marrë të drejtën e të qenit nikoqire. Komiteti ekzekutiv i UEFA-s u takua në Dublin më 3 dhjetor dhe vendosi

që gjysmëfinalët dhe finalja do të zhvillohen në Portugali. Gjysmëfinalja e parë do të mbahet më 5 qershor, ndërsa gjysmëfinalja e dytë një ditë më vonë, më 6 qershor. Dy kombëtalet që arrijnë të shkojnë deri në finale do të ndeshen mes vete më 9 qershor, për ta zbuluar se kush është kampioni i Ligës së Kombeve.

SHKURT

Konfirmohet turneu i tretë për klube

Komiteti Ekzekutiv i UEFA-s ka njoftuar futjen e një kompeticioni të tretë për klubet pas Ligës së Kampionëve dhe Evropa Ligës, i cili do të jetë i përbërë nga 32 skuadra dhe ku do të luhen plot 141 ndeshje. Ky kompeticion do të startojë në vitin 2021. Fituesi do të ketë të drejtën për të marrë pjesë në Evropa Ligë sezonin e ardhshëm. Ky turne nuk ka një emër zyrtar si dhe do të luhet të enjteve. Konfirmimi i UEFA-s për kompeticionin e ri: "Duke parë kërkesat e anëtarëve të ECA për ta rritur numrin e përgjithshëm të klubeve që marrin pjesë në kompeticionet për klube të UEFA-s, është marrë vendimi për të zhvilluar një kompeticion të tretë të përbërë nga 32 skuadra. Kjo sjell numrin e përgjithshëm të pjesëmarrësve në Ligën e Kampionëve, Evropa Ligë dhe kompeticioni i ri në 96 skuadra, me 32 ekipe pjesëmarrëse në çdo kompeticion".

Costa mungon dhjetë javë

Sulmuesi i Atletico Madridit, Diego Costa, do të mungojë rreth dhjetë javë, pasi do të operohet në Brazil. Costa ka probleme në këmbë dhe operimi duhet të ndodhë, kurse sulmuesi do të jetë gati për pjesën vendimtare të sezonit, si në La Liga, ashtu edhe në Ligën e Kampionëve. Në mungesë të Costës, Griezmannit do t'i ndihmojnë në sulm Kaliniqi, Gelsoni dhe Correa.

Hughesi shkarkohet pas barazimit ndaj Unitedit

Southamptoni e ka shkarkuar trajnerin Mark Hughes. Ky shkarkim ka ardhur pasi skuadra e Southamptonit barazoi me Manchester Unitedin në fundjavë (2-2), ani pse ishte në epërsi prej dy golave. Ish-trajneri i Manchester Cityt dhe Stoke Cityt edicionin e kaluar e kishte marrë drejtimin e Southamptonit në muajin mars dhe kishte arritur ta mbajë këtë klub në Premierë Ligë, por tash rezultatet e dobëta kanë ndikuar në shkarkimin e tij. Southamptoni pozicionohet në vendin e 18 në Premierë Ligë me vetëm nëntë pikë të grumbulluara.

Ramsey krahason Aubameyangun me Henryn

Aaron Ramsey e ka krahasuar Pierre-Emerick Aubameyang me legjendën e Arsenalit, Thierry Henry. "Aubameyang u kujton golat e Henrys. Ai është duke bërë një punë të shkëlqyer për ne", ka thënë Ramsey. Pierre-Emerick Aubameyang u transferua në Arsenal nga Borussia Dortmundi dhe me skuadrën angleze ka regjistruar 27 paraqitje dhe ka shënuar 20 gola.

VAR-i edhe në Ligën e Kampionëve

Në muajt e fundit kishte nisur një presion i vazhdueshëm nga klubet që në Ligën e Kampionëve të aplikohet sistemi VAR. Gabimet e gjyqtarëve u kanë kushtuar shtrenjtë klubeve në të shkuarën dhe tashmë e ndiejnë të nevojshme që të futet teknologjia, që të minimizohen gabimet, të cilat ndikojnë në fatin e rezultatit. Edhe pse VAR-i u testua në Kupën e Botës dhe aplikohet në disa prej kampionateve më elitare në Evropë, sërish drejtuesit e UEFA-s nguruan që ta fusnin që në fazën e grupeve, por ideja e tyre ishte që nga edicioni i ardhshëm VAR të ishte pjesë e Ligës së Kampionëve. Gjithsesi, nga zhvillimet e fundit, duket se institucioni më i lartë qeverisës i futbollit evropian është bindur, që më në fund sistemi VAR të jetë pjesë e Ligës së Kampionëve në këtë sezon. Duke nisur nga raundi i dytë, pra pas përfundimit të fazës së grupeve, sistemi VAR do të jetë pjesë e Ligës së Kampionëve.



EPOKA E RE						SHUFRA METALIKE TË LIDHURA SI SKELET NDËRMJET TYRE (sh.shq.)	KAFSHË E EGËR GJITARE (shq.)	SHTËPIZË ME DËRRASA (sh.shq.)	AKTORJA ISMAILI	EPOKA E RE	NDENJËSE E GJATË	ZANORE	PREMTIM SOLEMN PËR TË QËNDRUAR BESNIK (sh.shq.)	ASOCIAZIONE NAZIONALE ALOPECIA AREATA	CEREMONI FETARE	EDITA SOPJANI		
Autor: GAZMEND MORINA										LOKAL NATE ME PROGRAM ARTISTIK PIKË (ang.)								
AKTORJA E FAMSHME AMERIKANE JESSICA																		
SHTET NË AFRIKË												KËNGËTARI POTOKU QYTET I MADH NË GJERMANI						
KUKULLAT																APARTAMENT (sh.shq.)		
KËNGËTARE E NJOHUR AMERIKANE (shqip.)																BASHKËT. RESTORANT, KAFE		
SHKENCA MBI MORALIN ZANORE							ZANORE IDRIZ BALAJ		KLUB BASKETBOLLI NË ITALI KUNDËRSHTARI I BOLSHEVIZMIT RUS								"LOS ANGELES" ANË E MPREHTË E NJË VEGLE	
KALORËS MESJETAR											NOTË MUZIKORE	ARMË GJAHU ME NJË TYTË DHE ME FISHEKË SI TË CIFTES PORTIERI LIKA						
EPOKA E RE						FUTBOLLISTI URUGUAIAN NË FOTO (PSG)	TENISTJA SHARAPOVA	I PLOGËT	PESHA E MALLIT PA AMBALAZH	ELVIN ZAJMI	AZEM BEJTA LARTËSI QË ARRIN NJË SIPËRFAQE UJI E LIRË						NDESH FUTBOLLISTI GOKHAN (NAPOLI)	
I SHQUAR, I DALLUAR																	NOTË MUZIKORE VËNIA E DATËS NË KALENDAR	
BANORI I NJË SHTETI SKANDINAV																	TREVISO VEND I HAPUR NË MURIN E NJË SHTËPIE	
IRNOSET (bised.)									KOMPOZITORI ITALIAN XHYZEPE								ZYRTARIZIM I NJË MARRËVESHJE NDËRKOMBËTARE (sh.shq.)	
AKTORI AMERIKANE ROBERT DE									KËNGËTARJA ZAHARIA NDODHJE NË NJË VEND TJETËR NË ÇASTIN KUR ËSHTË KRYER NJË KRIM									
PIKTORI VALLA ZANORE							RAMADAN (perkdh.)	OMANI, LIBERIA E TRAZOJ										
NDJENJË E RESPEKTIT DHE E VLERËSIMIT TË LARTË																		
LLOJ BIME NARKOTIKE																	EMMA FAZZUOLI REGJISORJA GJONI (shq.)	
ZBËRTHIM I NJË ÇËSHTJE																	ZANORE KUNDREJT I FORTI	
BASHKËT.							"KENIA" VIJA QË SHPIE UJIN NË MULLI		KRYEQYTETI I JORDANISË (pashq.) FUTBOLLISTI ABIDAL		TASH						QESËNDISËS ALBANOLOGIA DURHAM	
PJESA MË E LARTË E NJË MALI QË IA PRET MENDJA; I SHKATHËT																	JETA E QETË SHKRONJË GREKE	
VEÇIMI																	LUFTËTARI I LUFTËS SË SPANJËS VOKSHI DUKAT	
EPOKA E RE						SHKENCËTARI NJUTON (shq.)											INITIATIVE GLOBUS EUROPE ZANORE	
E NJËSUAR, E BASHKUAR																	UGANDA, TANZANIA	



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Republic Of Kosovo



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren-Municipality Of Prizren

Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural- Autoriteti Pyjor Komunal-Prizren

Nr.2016 /2018 dt.30.11.2018

Duke u bazuar në Ligjin për Pyjet e Kosovës 2003/03 dhe Udhëzimit Administrativ MA-Nr.06/2010 14/2011, lidhur me shitjen e trungjeve pyjore dhe asortimenteve drusore, drutë e konfiskuara, gjatë viti 2017/2018.

DBZHR-AKP, me kërkesë për shitjen e druve të konfiskuara i është drejtuar, Kryetarit të Komunës dhe Kryetari Komunës lëshonë këtë:

Vendim nr. 01/060-168909 dt.20.11.2018

Shpall

Ankand / T e n d e r- nr. 02/2018, DBZHR-Autoriteti Pyjor Komunal Prizren

Shitja e Druve të Konfiskuara

Ftohen të gjithë Operatorët Ekonomik të licencuar, dhe personat fizik që janë të interesuara për blerjen e masës drunore të stivosura në depot e Pyltaris ne Prizren, që të dorëzojnë ofertat e tyre për sasinë drunore të evidentuar në tabelat e poshtëshënuara.

Nr	DBZHR-Autoriteti Komunal Pyjor Prizren	Vendi-Deponimi	Lloji i drurit	Sasia-m ³		Çmimi fillestar Euro/m ³		Vlera Euro €
				teknike	Zjarri	teknike	Zjarri	
1	Njësia Pyjore Prizren	Depo e Pyltaris Prizren	Të perzira		48.70 m ³		23.00	1120.10
			totali					

Të drejtë konkurimi kanë të gjitha personat fizik dhe juridik, ndërmarrjet që kanë licencën lëshuar në pajtim me UA-03/2008 si dhe të regjistruar veprimtarinë e kultivimit dhe shfrytëzimit të pyjeve për pikën a), ndërsa të gjitha ndërmarrjet tjera për pikën b).

Ndërmarrjet duhet t'i ofrojnë dëshmitë për përmbushjen e të gjitha obligimeve tatimore, së paku deri në tremujorin e fundit para dorëzimit të ankandit -tenderit. Të gjitha ndërmarrjet të cilat nuk i kanë përmbushur obligimet nga kontratat e mëhershme me Autoritetin Komunal Pyjor nuk do të jenë në konkurrencë për të fituar në këtë ankand/ tender.

Oferta duhet të përmbajë per kompanit e liqencume ;

- Licencën e lëshuar në pajtim me UA-03/2008 (vetëm për ngastra pyjore)
- Çmimin e ofruar për 1m³ të asortimenteve drunore veç e veç për dru zjarri dhe lendë teknike.
- Dëshmi të lëshuara nga Drejtoria Koordinuese e APK-së dhe DBZHR-AKP,ku aplikon, se kundër subjektit përkatës nuk ka të ngritur ndonjë procedurë për dëme pyjore.
- Referencë-dëshmi mbi kryerjen me sukses të punëve të realizuara nga kontratat e mëhershme në APK dhe DBZHR-AKP, (nëse ka pasur) dhe nuk ka obligime të pa kryera.
- Flet regjistrimin e ndërmarrjes, me veprimtarinë e kërkuar si më lartë
- Dëshmitë mbi kryerjen e obligimeve tatimore së paku deri në tremujorin e fundit para dorëzimit të tenderit.
- Afati kohor-dinamika e realizimit të punëve per terheqjen
- Dëftesa për pagesën e shumës prej 20 €, për pjesmarrje në ankand-tender.

Oferta duhet të përmbajë për persona fizik:

1. letërnjoftimin
2. Dëftesa për pagesën e shumës prej 20 €, për pjesmarrje në ankand-tender
3. Afati kohor-dinamika e realizimit të punëve per terheqjen

Informatat detale për masën drunore mund të mirren-bëhen në Njësitë Komunale e Pyjeve në Prizren.

Afati i fundit për dorëzimin e ofertave, bëhen në zyren e prokurimit dhe do të jetë më datën 18. 12. 2018 deri në ora 13. 30, dorëzimi i ofertave bëhet në sportelin nr 2 në Ndërtesën e administratës Komunale të Prizrenit, ndërsa hapja do të bëhet të njëjtën ditë në ora; 14:00 në zyren e prokurimit.

Ofertat duhet të jenë të mbyllura.

Hapja e ofertave në pajtim me orarin e sipërcekur, do të bëhet nga komisioni.

Të gjitha të drejtat dhe obligimet që dalin nga ky ankand/tender përcaktohen me Kontratë mes Drejtoris Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural-Autoriteti Komunal Pyjor dhe fituesit të ankandit/tenderit.

Ankandi/tenderi do të jetë jetë i hapur nga data 04. 12. 2018 deri më 18. 12. 2018



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI KOMUNËS MALISHEVË



Zyra e Personelit

Nr.01/1709

Më:03/12/2018

Në mbështetje të dispozitave të nenit 11, të Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, nenit 15 dhe 17 të Rregullores Nr. 02/2010, për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Udhëheqësi i Personelit shpall:

KONKURS

Për plotësimin e vendit të punës

DREJTORIA PËR INSPEKTORIAT

1. (Një) Inspektor i Veterinës

Kualifikimi i kërkuar: Diploma e Fakultetit të Bujqësisë dhe Veterinës, dega e veterinarisë

Përvojë e punës: 3 vite përvojë pune profesionale;

Koeficienti: 6

Kodi i vendit të punës INS/070

Numri i referencës: RN000041110

Përshkrimi i detyrave të punës:

-Ndërmerr masa për inspektimin e produkteve të mishit, qumështit, bulmetit dhe produkteve tjera;

- Ndërmerr masa administrative dhe masa tjera ndaj personave fizik dhe juridik duke u bazuar në ligjin mbi inspeksionin e veterinarisë;

- Ben hapjen dhe mbylljen e objektit, për qëllime të inspektimit;

- Ben konfiskimin e mallit të dyshimte, apo të prishur ndërsa mallin i cili paraqet rrezik për shëndetin publik e asgjëson si dhe bene tërheqjen e mallit të dyshimte nga qarkullimi;

- Ben ndalimin e ushtrimit të veprimtarisë, përkatësisht kryerjen e punëve të caktuara, për kohe të caktuara;

- Ben ndërmarrjen e veprimeve lidhur me mostrat, kontrollon produktet me qëllim të verifikimit dhe harmonizimit në pikëpamje sanitare në bazë të dispozitave ligjore në fuqi;

- Ben ndërmarrjen e masave për evitimin e rrezikut për jete, shëndetin e njerëzve dhe shëndetin e kafshëve apo mbrojtjen e interesit publik;

- Ben iniciimin e procedurave kundërvajtës dhe ushtron fletëparaqitjen penale si dhe pune të tjera që rrjedhin nga natyra e punës së inspektorit të Veterinës, si dhe pune të tjera të parashtruara nga mbikëqyrësi. Dokumentet e kërkuara:

-Diploma e përgatitjes profesionale;

-I.ctërnjoftimi (fotokopje);

-certifikata e lindjes;

-certifikata për trajnimet e kryera;

-Vërtetimin e përvojës së punës;

-certifikata që nuk jeni nën hetime;

Të gjithë të interesuarit që dëshirojnë të aplikojnë në këto vende të punës janë të obliguar që t'i marrin dhe dorëzojnë aplikacionet në **Zyrën për pritjen e palëve të KK- Malishevë**. Konkursi do të mbetet i hapur 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e shpalljes së tij në të përditshmen "**EpoKa e re**" dhe në tabelë të shpalljeve të **KK- Malishevë**. Për intervistë do të njoftoheni me kohë.

Udhëheqësi i Personelit
Gani Bahtjaraj, jur.dipl.



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIC OF KOSOVO/REPUBLIKA KOSOVA
QEVERIA E KOSOVËS/GOVERNMENT OF KOSOVA/ VLADA KOSOVA

MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE- MINISTRY OF CULTURE, YOUTH AND SPORTS-MINISTARSTVO
ZA KULTURU, OMLADINU I SPORTIA

NJOFTIM PËR ANULIMIN E KONKURISIT

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit mbështetur në Procedurat e Rekrutimit, njofton për anulimin e konkursit të shpallur me datë 08.09.2018, me Nr. të Ref. 39/2018, për shkak të disa defekteve procedurale dhe mangësive të cilat janë vërejtur më vonë në proces e sipër, e që kanë të bëjnë me kriteret bazë të konkursit dhe gjithnjë në funksion të procedurës fer dhe transparente, vendoset anulimi i procedurës rekrutuese per pozitën Arkeolog në IAK.

OBAVEŠTENJE O ANULIRANJU KONKURSA

Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta, oslanjajući se na Procedure o Rekrutaciji, izdaje obaveštenje za anuliranje konkursa, objavljenog datuma 08.09.2018, sa Br. Ref. 39/2018, zbog nekih proceduralnih defekata i nedostataka koja su primećena kasnije, tokom procesa a koja se tiču sa osnovnim kriterijumima konkursa, uvek u funkciji fer i transparentne procedure, odlučuje se anuliranje procedure za regrutaciju za položaj Arheolog u AIK-u.



Në bazë të nenit 21 të Ligjit për Ndërmarrje Publike Nr. 03/L-087 i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin 04/L-111 harmoni me Kodit të Etikës dhe Qeverisja Korporative për Ndërmarrjet Publike dhe nenit 21.3.6 të Statutit të KRM "UNITETI"SHA-Mitrovicë, Bordi i Drejtorëve në takimin e rregullt me datë 26.11.2018 dhe vazhdimin e mbledhjes me 29.11.2018, vendosi që me datë 04.12.2018 të shpall ketë:

KONKURS

Pozita: Sekretar i KRM "UNITETI" Sh.a
I përgjigjet: Bordit të Drejtorëve-Drejtorit Ekzekutiv
Vendi: Mitrovicë

Kushtet dhe kualifikimet e kërkuara:

- Të ketë diplomën Univerzitare të Fakultetit Juridik,
- Të ketë së paku 3 vite përvojë pune profesionale
- Të ketë integritet të lartë moral dhe profesional
- Të ketë aftësi të dëshmuara në menaxhim
- Të ketë njohuri të mira të punës me kompjuter (Microsoft, Word, Excel etj.)
- Të jetë njohës i mirë i gjuhëve zyrtare
- Vërtetimin nga Gjykata që nuk është nën hetime
- Të jetë komunikativ dhe të ketë aftësi organizative dhe menaxheriale

Detyrat dhe përgjegjësit kryesore:

- Do të mbaj regjistrin e akcionarëve .
- Veproji si agjenti i Kompanisë për pranimin e njoftimeve.
- Të bëjë të gjitha arkivimet e nevojshme, publikimet dhe njoftimet me autoritetet e duhura që kërkohet me ligj dhe me akte nënligjore.
- Të mbikqyrë mirmbajtjen e duhur dhe azhurimin e rregullt të ueb faqes të parashikuar me seksionin VIII(6)
- Të koordinojë me KSHE-në pregaditjen e shkresave për mbledhjet të Bordit të Drejtorëve.
- Sekretari do të mbajë procesverbalin për secilën mbledhje të Përgjithshme dhe Mbledhjet të Bordit të Drejtorëve dhe Komitetit për Auditim (Përveç nëse udhëzohet ndryshe nga kryesuesi i tyre) si dhe do të shenojë ato në librin e procesverbaleve. Procesverbali duhet të përmbajë informatat në vijim: emrat e të pranishëmve, vendin dhe datën mbledhjes, çështjet kryesore që ngrihen gjatë diskutimit të pikave individuale të rendit të ditës, tekstin e vendimit të propozuar rezultatin e votimit dhe votat e dhëna nga secili individ, tekstin e saktë të vendimeve të miratuara si dhe çfarëdo kundërshtimi të bërë lidhur me ato vendime.
- Procesverbali i mbledhjes së kuvendit të nënshkruar nga kryesuesi i Kuvendit dhe Sekretari dhe dorzohet për tu miratuar në mbledhjen e ardhshme të Kuvendit
- Procesverbali i secilës mbledhje të Bordit të Drejtorëve duhet të dorzohet për aprovim në mbledhjen e ardhshme të Bordit të Drejtorëve dhe duhet të nëshkruhet nga Kryesuesi i Bordit të Drejtorëve dhe Sekretarit.

Procedura e aplikimit:

- Aplikacionit duhet bashkangjitur edhe këto dokumente:
- CV-ja (Biografia),
- Kopja e letërnjoftimit,
- Letër motivimi,
- Deklarata nën betim
- Diplomën e fakultetit - kopje,
- Dëshmitë e përvojës paraprake të punës,
- Dëshminë se nuk jeni nën hetime, jo më të vjetër se 3 muaj.
- Programi zhvillimor për kompaninë

Dorëzimi i kërkesës dhe dokumentacionit përkatës bëhet tek Sekretaria e Kompanisë në zarf të mbyllur me shënim: "Për pozitë e Sekretarës të KRM. "UNITETI" SH.A. Mitrovicë.

Konkursi zgjatë 15 ditë, dorëzimi i dokumentave fillon nga data 04.12.2018, dhe përfundon në ora 16.00 të datës . . . 2018

Kërkesat e dorëzuara pas afatit dhe të pakompletuar me dokumentacione përkatëse, nuk do të merren për shqyrtim nga ana e Bordit Drejtorëve. Vlerësimi formal dhe intervista do të bëhen pas përfundimit të afatit për aplikim, ndërsa NP mban të drejtën e formimit të listës së shkurtër me aplikant.



Në bazë të nenit 21 të Ligjit për Ndërmarrje Publike Nr. 03/L-087 i ndryshuar, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin 04/L-111 dhe në harmoni me ligjin për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim Ligjor nr 06/L-032 Kodit të Etikës dhe Qeverisja Korporative për Ndërmarrjet Publike dhe nenit 21.3.6 të Statutit të KRM "UNITETI"SHA-Mitrovicë, Bordi i Drejtorëve në takimin e rregullt me datë 26.11.2018 të vazhdimin të mbledhjes me 29.11.2018, vendosi që me datë 04.12.2018 të shpall ketë:

KONKURS

Pozita: Zyrtar kryesor Financiar dhe i Thesarit (ZKF)KRM"UNITETI"Sh.a
I përgjigjet: Bordit të Drejtorëve-Drejtorit Ekzekutiv
Vendi: Mitrovicë

Kushtet dhe kualifikimet e kërkuara:

- Të ketë diplomën Univerzitare të Fakultetit Ekonomik-Financa kontabilitet
- Të dëshirueshëm SCAAK ,IKAF , ose shoqatat tjera profesionale
- Të ketë së paku 3 vite përvojë pune si kontabilist, Drejtor Financiar.
- Njohuri të shkëlqyera të Financave Publike
- Të ketë integritet të lartë moral dhe profesional
- Të ketë aftësi të dëshmuara në menaxhimin e financave
- Të ketë njohuri të mira të punës me kompjuter(Microsoft, Word, Excel etj.)
- Të jetë njohës i mirë i gjuhëve zyrtare
- Të mos jetë i denuar ose nën hetime
- Shkathësi të larta organizative dhe aftësi për të punuar nën presion me kualitete të larta organizativ.

Detyrat kryesore dhe përgjegjësitë:

- Do të menaxhoi , nën drejtimin dhe përgjegjësinë e KSHE-së , punët financiare të Kompanisë - mbrenda kufizimeve të krijuara nga Bordi i Drejtorëve- do të ketë autoritetin për të lidhë Kompaninë në kontratë në të gjitha transaksionet financiare dhe të jetë përgjegjës,
- Të mbaj llogaritë e Kompanisë të azhuruara dhe të sakta .
- Të krijojë dhe të udhëheqë të gjitha kontrollet e mbrendshme financiare , përfshirë blerjetë , faturat e të hollave , dhe mjeteve themelore fikse. Të monitoroj llogaritë e pagushme dhe të koordinojë pagesat e faturave dhe blerjeve të posaqme. Të kontrolloj shpenzimet e punëtorëve për të siguruar përptushmëri me politikën korporative dhe Buxhetin para pagesesë.
- Të pregadisë shënimet e Kompanisë për auditimin e fundvitit.
- Të bëjë shqyrtimin, organizoi prokurimin dhe mbajtjen e të gjitha polisave të sigurimit afarist
- Të koordinojë funksionet tjera të biznesit , si qiratë e ndërtesave, paisjeve dhe blerjetë me KSHE-në dhe Zyrtarin e Prokurimit të Kompanisë.
- Të menagjoj thesarin e Kompanisë.
- Të caktoj dhe të pregadisë buxhetin.
- Detyrat tjera që përcaktohen nga KSHE-ja

Procedura e aplikimit:

- Aplikacionit duhet bashkangjitur edhe këto dokumente:
- CV-ja (Biografia),
- Kopja e letërnjoftimit,
- Letër motivimi,
- Deklarata nën betim
- Diplomën e fakultetit - kopje,
- Dëshmitë e përvojës paraprake të punës,
- Dëshminë se nuk jeni nën hetime, jo më të vjetër se 3 muaj.
- Programi zhvillimor për kompaninë
- Të jetë komunikativ dhe të ketë aftësi organizativ dhe menaxheriale

Dorëzimi i kërkesës dhe dokumentacionit përkatës bëhet tek Sekretaria e Kompanisë në zarf të mbyllur me shënim: "Për pozitë e Sekretarës të KRM. "UNITETI" SH.A. Mitrovicë. Konkursi zgjatë 15 ditë, dorëzimi i dokumentave fillon nga data 04.12.2018, dhe përfundon në ora 16.00 të datës 20.12.2018. Kërkesat e dorëzuara pas afatit dhe të pakompletuar me dokumentacione përkatëse, nuk do të merren për shqyrtim nga ana e Bordit Drejtorëve. Vlerësimi formal dhe intervista do të bëhen pas përfundimit të afatit për aplikim, ndërsa NP mban të drejtën e formimit të listës së shkurtër me aplikant.



Në bazë të nenit 21 të Ligjit për Ndërmarrje Publike Nr. 03/L-087, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin 04/L-111 dhe në harmoni me Ligjin për Kontabilitet, Raportimin Financiar dhe Auditimit Ligji nr 06/L-032 Kodit të Etikës dhe Qeverisja Korporative për Ndërmarrjet Publike dhe nenit 21.3.6 të Statutit të KRM "UNITETI"SHA-Mitrovicë, Bordi i Drejtorëve në takimin e rregullt me datë 26.11.2018, dhe vazhdimin e mbledhjes me 29.11.2018 vendosi që me datë 04.12.2018 të shpall ketë:

KONKURS

Pozita: Zyrtar për Auditim të Brendshëm KRM"UNITETI"Sh.a
I përgjigjet: Komitetit të Auditimit-Drejtorit Ekzekutiv
Vendi: Mitrovicë

Kushtet dhe kualifikimet e kërkuara:

- Të ketë diplomën Univerzitare të Fakultetit Ekonomik-Financa kontabilitet
- Të dëshirueshëm SCAAK IKAF ose shoqatat tjera profesionale,
- Të ketë së paku 3 vite përvojë pune në auditim.
- Të jetë i certifikuar.
- Të ketë integritet të lartë moral dhe profesional
- Të ketë njohuri të shkëlqyera të Financave Publike, aftësi të dëshmuara në proceset e auditimit .
- Të ketë njohuri të mira të punës me kompjuter(Microsoft, Word, Excel etj.)
- Të jetë njohës i mirë i gjuhëve zyrtare
- Të mos jetë i denuar ose nën hetime
- Të shkathësi të larta organizative dhe aftësi për të punuar nën presion me kualitete të larta

Detyrat kryesore dhe përgjegjësitë:

- Nën drejtimin dhe mbikëqyrjen e Komitetit për Auditim dhe duke i raportuar ekskluzivisht atij, Zyrtari për Auditim të Brendshëm do të jetë përgjegjës që të :
- Të udhëheqë, menaxhojë dhe organizojë zyrën për auditim të brendshëm Të udhëheqë dhe drejtojë të gjitha aktivitetet e auditimit të brendshëm.
- Të gjitha detyrat tjera të përcaktuara nga Komiteti i Auditimit.

Procedura e aplikimit:

- Aplikacionit duhet bashkangjitur edhe këto dokumente:
- CV-ja (Biografia),
- Kopja e letërnjoftimit,
- Letër motivimi,
- Deklarata nën betim
- Diplomën e fakultetit - kopje,
- Dëshmitë e përvojës paraprake të punës,
- Dëshminë se nuk jeni nën hetime, jo më të vjetër se 3 muaj.

Dorëzimi i kërkesës dhe dokumentacionit përkatës bëhet tek Sekretaria e Kompanisë në zarf të mbyllur me shënim: "Për pozitë e Sekretarës të KRM. "UNITETI" SH.A. Mitrovicë.

Konkursi zgjatë 15 ditë, dorëzimi i dokumentave fillon nga data 04.12.2018, dhe përfundon në ora 16.00 të datës 20.12.2018.

Kërkesat e dorëzuara pas afatit dhe të pakompletuar me dokumentacione përkatëse, nuk do të merren për shqyrtim nga ana e Bordit Drejtorëve. Vlerësimi formal dhe intervista do të bëhen pas përfundimit të afatit për aplikim, ndërsa NP mban të drejtën e formimit të listës së shkurtër me aplikant.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
Ministarstvo Trgovine i Industrije - Ministry of Trade and Industry

Në pajtim me dispozitat e Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligji Nr. 03/L-149, Rregullore Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë bën:

REKRUTIM

Institucioni: Ministria e Tregtisë dhe Industrisë

Agjencia për pronësi industriale

Titulli i vendit të punës: Zyrtar i lartë për ekzaminim

Koeficienti / 8

Nr. i Referencës: MTI/ 15

Numri i zyrtarëve që do të pranohen: 1

Vendi: Prishtinë

Data: 4.12.2018

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Zhvillon dhe arrin pëlqimin për planet e punës dhe afatet, në koordinim me mbikëqyrësin, për zbatimin e projekteve, shërbimeve dhe produkteve përkatëse në fushën profesionale specifike;
- Kryen detyra e parapara në planet e punës të miratuara në përputhje me ligjet, rregulloret, politikatat dhe procedurat përkatëse, brenda afateve kohore të caktuara;
- Bën hulumtime, analiza, vlerësim të opsioneve dhe rekomandime për shqyrtim nga nivelet e larta rreth detyrave ose projekteve të specializuara të miratuara;
- Udhëheq grupet punuese në fushën profesionale specifike kur kërkohet një gjë e tillë;
- Ofron këshilla për stafin e nivelit më të ulët brenda njësisë organizative për ekzekutimin e detyrave dhe përgjegjësi të tyre;
- Ofron këshilla në fushën e ekspertizës të kërkuar brenda institucionit;
- Koordinon punën me pjesët tjera të institucionit dhe komunikon, sipas nevojës, me autoritetet e jashtme;
- Kryen çdo detyrë tjetër në fushën profesionale specifike në përputhje me ligjet dhe rregulloret aktuale të cilat mund të kërkohen në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe.

Kualifikimet për këtë vend të punës:

- Diplomë Universitare: Juridik, Ekonomik, Shkenca Teknike, Teknologjike;
- Minimum 3 vite përvojë pune profesionale;
- Njohuri të thellë dhe të specializuara në fushën profesionale specifike të fituar përmes arsimimit universitar dhe trajnimeve përkatëse;
- Njohuri të ligjeve dhe rregullore të aplikueshme;
- Shkathtësi në komunikim planifikim të punës dhe udhëheqje të ekipit;
- Shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale;
- Shkathtësi kompjuterike në aplikacione të programeve (Word, Excel, Power Point, Access);

Kushtet e pjesëmarrjes në rekrutim:

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës, të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, kanë shkollimin e lartë dhe kanë aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave.

Kohëzgjatja e emërimit:

Nëpunësi i karrierës (përhershëm) Periudha provuese .Dymbëdhjetë (12) muaj.

Data e mbylljes së konkursit:

18.12.2018.

Paraqitja e kërkesave

Formularët për aplikim mund të merren në recepcion të MTI-së, ose të tërhiqen nga web faqja e MTI-së, ku është bërë edhe shpallja e konkursit , në adresën www.mti-ks.org dhe dorëzohen në Divizionin e Burimeve Njerëzore, çdo ditë punë nga ora 8:00 -16:00 deri më: 18.12.2018. Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni në nr. tel. 038-200 36-578.

"Shërbimi Civil i Republikës së Kosovës, ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë".

"Komitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcionalë organet e shërbimit civil të administratës publike,qendrore dhe lokale,sic specifikohet në Nenin 11, paragrafi 3 të Ligjit Nr..03/L-149 mbi shërbimin Civil të Republikës së Kosovës"

Kërkesat e pakompletuara si dhe kërkesat e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen.

Për shkak të numrit të madh të kërkesave të pranuar,vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
Ministarstvo Trgovine i Industrije - Ministry of Trade and Industry

U skladu sa odredbama Zakona o Civilnoj Službi Republike Kosova Zakon Br. 03/I -149, Pravilnikom Br 02/2010 o o Procedurama Rekrutacije u Civilnoj Službi Republike Kosovo, Ministarstvo Trgovine i Industrije obavlja:

REGRUTOVANJE

Institucija: Ministarstvo Trgovine i Industrije

Agencija za Industrijsku Svojinu

Naziv radnog mesta: Viši Službenik za Egzaminiranje

Koeficijent: / 8

Br. Referencije: MTI/ 15

Broj službenika koji će biti prihvaćeni: 1

Mesto: Priština

Datum:4.12.2018

Obaveze i odgovornosti:

- U koordinaciji sa nadzornikom razvija i postiže saglasnost o planovima rada i rokovima, za primenu relevantnih projekata, usluga i proizvoda u specifičnoj stručnoj oblasti;
- Obavlja zadatke predviđene u planovima rada usvojenim u skladu sa zakonom, propisima, politikama i procedurama, u određenim vremenskim rokovima;
- Izvršava istraživanje, analizu, procenu opcija i preporuke za pregled na visokom nivou o odobrenim specijalizovanim zadacima ili projektima;
- Upravlja radnim grupama iz stručne specifične oblasti kada je to potrebno;
- Pružava savete nižem nivou osoblja u organizacionoj jedinici za izvršavanje njihovih dužnosti i odgovornosti;
- Pružava savete u oblasti ekspertize koja se zahteva u okviru institucije;
- Koordinira rad sa drugim delovima institucije i komunicira, prema potrebi, sa vanjskim vlastima;
- Obavlja i sve druge obaveze u specifičnoj profesionalnoj oblasti u skladu sa važećim zakonima i propisima, koje se razumno mogu povremeno zahtevati.

Kualifikimet për këtë vend të punës:

- Univerzitetaska Diploma: Pravni Fakultet, Ekonomski, Tehnička, Tehnološka Nauka;
- Minimum 3 godine radnog iskustva u struci;
- Duboko znanje i stručnost u specifičnoj stručnoj oblasti stečeno kroz visoko obrazovanje i odgovarajuću obuku;
- Poznavanje primenljivih zakona i propisa;
- Veštine u komunikaciji, planiranju i vođenju tima;
- Istraživačke, analitičke i ocenjivačke veštine i formulisanje stručnih preporuka i saveta;
- Kompjuterske veštine u softverskim aplikacijama (Word, Excel, Power Point, Access);

Uslovi za učesće na regrutaciji:

Pravo apliciranja imaju svi punoletni građani Republike Kosovo koji imaju punu poslovnu sposobnost, imaju visoku školsku spremu i stručnu sposobnost za obavljanje obaveza.

Trajanje imenovanja:

Službenik karijere (stalni). Probni period dvanaest (12) meseci.

Datum zatvaranja konkursa:

18.12.2018

Podnošenje prijave

Obrazac za prijavu se može dobiti na recepciji MTI-a, ili preuzeti sa web stranice MTI-a, gde je i objavljen konkurs, na adresi www.mti-ks.org i dostavlja se Diviziji za Ljudske Resurse svaki radni dan od 8:00 -16:00 do: 18.12.2018. Za detaljnije informacije možete kontaktirati broj tel. 038-200 36-578.

"Civilna Služba Republike Kosovo, pruža jednake mogućnosti zapošljavanja za sve građane Kosova i pozdravlja aplikacije svih osoba muškog i ženskog pola svih zajednica na Kosovu".

"Manjinske zajednice i njihovi pripadnici imaju pravo na pravično i proporcionalno zastupljenost organi civilne službe javne, centralne i lokalne administracije, kao što je navedeno u Člamu 11, stav 3 Zakona Br.03 / L-149 o Civilnoj Službi Republike Kosovo"

Zahtevi pristigli nakon određenog roka i nepotpune prijave neće biti prihvaćene.

Zbog velikog broja primljenih prijava biće kontaktirani samo kandidati sa užeg spiska.



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

NJOFTIM

Të gjithë investitorët potencial që planifikojnë të ofertojnë në
Shitjen 43
të aseteve të ndërmarrjeve në Likuidim, njoftohen se:

Dita e dorëzimit dhe hapja e ofertave është: **e mërkurë 05 dhjetor 2018**, prej orës **10:00 - 12:00**,

Vërejtje: Njësitë në vijim janë tërhequr nga Shitja 43 e Aseteve në Likuidim:

- Njësia nr.15: NSH Lux Lokali 30 Korriku I
- Njësia nr.16: NSH Lux Lokali 30 Korriku II
- Njësia nr.17: NSH Lux Lokali Kozmetika
- Njësia nr.20: NSH LUX Lokali Treshnja


DORËZIMI I OFERTAVE

në Sallën e konferencave të Hotelit Grand

Si duhet të përgatitet oferta:

OFERTA E JUAJ DUHET TË PËRMBAJ 3 PLIKO (ZARFE).

Të gjitha dokumentet e ofertës duhet të vendosen në një pliko (zarf) të madh e të mbyllur – shih më poshtë: **ZARFI 3**
Brenda këtij zarfi (**ZARFI 3**), ju duhet të vendosni dy zarfe të tjera të mbyllura: **ZARFI 1** dhe **ZARFI 2**



Dokumentet në vijim duhet të vendosen brenda zarfit

“Informata shtesë për ofertën”

1. Dokumentet e cekura në pikën 8.6. ii të Rregullave të Tenderit.
2. Origjinalin e formularit për dorëzimin e ofertës - **“SHTOJA C”**, e plotësuar dhe nënshkruar nga ofertuesi.
3. Dëshmi e cila tregon që tarifa për dorëzimin e ofertës është transferuar në llogarinë e AKP-së.
4. Dëshmi e cila tregon që depozita e ofertës është transferuar në llogarinë përkatëse të AKP-së.

The image shows a sample of the 'SHTOJA B' - PASQYRA E ÇMIMIT TE OFERTES form. It includes fields for 'Emri i Plotë i Ofertuesit', 'Numri i njësisë dhe emri i aseti/objektit të ri', 'SHAL numër', and a table for 'ÇMIMI I OFERTËS'. A vertical label on the right side reads 'TË PLOTËSOHEN TË GJITHA FUSHAT!! KUIDES,'. Arrows point to various fields in the form.

* Të gjithë ofertuesit potencial të cilët planifikojnë të dorëzojnë ofertën për asetet e përfshira në **Shitjen nr. 43 të Aseteve** janë të obliguar që të përdorin dhe të plotësojnë në tërësi VETËM shtojcat në formatin e përfshirë në Rregullat e Tenderit në fuqi, përndryshe oferta e tyre mund të **DISKUALIFIKOHET!**
Formularët mund të shkarkohen në ueb faqen e AKP-së apo të tërhiqen në zyrën e marketingut në AKP.

LLOGARITË BANKARE PËR LIKUIDIM:

Tarifa për dorëzimin e ofertës prej 300 € (treqind Euro) duhet t'i paguhet AKP-së në BQK. Numri i llogarisë është: 1000510000000173
Depozita e ofertës duhet t'i paguhet AKP-së në BQK. Numri i llogarisë është: 1000510000000076

Për më shumë kontakttoni - Njësine për Marketing dhe Marrëdhënie me Investitorë
Rr. Agim Ramadani Nr. 23, (ish Rr. Ilir Konushevc Nr.8), 10 000 Prishtinë, Kosovë
tel: + 383 (0) 38 500 400 lok. 2004, 1090,1105, ose 1152 / fax: + 383 (0) 38 248 076
e-mail: shitja@pak-ks.org ose sales@pak-ks.org; www.pak-ks.org



Republika e Kosovës
 Republika Kosova-Republic of Kosovo
 Qeveria - Vlada-Government
 MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCES DHE TEKNOLOGJIS
 AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIM PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TË RRRITUR
 AGENCIA ZA PROFESIONALNO OBRAZOVANJE I OSPOSOBLAVANJE I OBRAZOVANJE ZA ODRASLE
 AGENCY FOR VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING AND ADULT EDUCATION

Nr: 625/1
 Dt: 03.12.2018

Në bazë të Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-032, Neni 4, Ligjit të Punës nr03/L-212, Ligjit për Arsimin dhe Aftësimin Profesional 04/L-138, Neni 13 dhe 34, Udhëzimit Administrativ Nr. 05/2012 (Neni 4), Udhëzimit Administrativ Nr. 07/2017, Udhëzimit Administrativ 05/2015, si dhe në bazë të kërkesave të shkollave Agjencioni për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur shpall:

KONKURS

Për plotësimin e vendeve të lira të punës në Qendrën e Kompetencës në Ferizaj, Sh. M. M "Shtjefen Gjeqovi", në Prishtinë për vitin shkollor 2018/2019

Niveli	Institucioni/Shkola	Vendi	Pozita/Vendi i lirë	Vendi lirë/ Zëvendësim
SHML	Qendra e Kompetencës	Ferizaj	Një (1) mësimdhënës për profilin e As Kujdesi Social 10 orë mësimore dhe 4 orë për Profilin e As i Fizioterapisë gjithsej 14 orë të lira mësimore;	Vendi i lirë
Niveli	Institucioni/Shkolla	Vendi	Pozita/Vendi i ilirë	Vendi lirë/ Zëvendësim
Sh.M.M	"Shtjefen Gjeqovi"	Prishtinë	Një (1) mësimdhënës/e për lëndën e Gjuhës dhe letërsi shqipe me 20 orë mësimore; Një (1) mësimdhënës s/e për lenden e Vizatimit teknik 5 orë , Mekanik teknike 4 orë dhe 12 orë praktik profesionale INK	Vendi i lirë Zëvendësim deri në kthimin nga pushimi i lehonisë

Detyrat dhe Përgjegjësitë për mësimdhënës të nivelit të IV-të;

- Mësimdhënësi është i obliguar ta realizojë planprogramin mësimor për vendin përkatës të punës duke u bazuar në Ligjin mbi Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës dhe në aktet e tjera nënligjore, të cilat i rregullojnë fushat përkatëse relevante për vendin e tij/ saj të punës.
- Të zbatojë detyrat e punës duke siguruar cilësinë dhe kompetencën profesionale në procesin e mësimdhënies.
- Të zbatojë metodologjitë e reja të mësimdhënies dhe të vlerësimit në përputhje me udhëzimet e planprogramit të ri.
- Të tregojë respekt dhe të sillet me drejtësi e pa dallime me njerëzit me të cilët punon.
- Të respektojë autoritetin e drejtpërdrejtë të zyrtarit të cilit i raporton dhe t'i kryejë detyrat që mund t'ua caktoj ai/ajo. Detyrat e punës duhet të jenë në harmoni me legjislacionin në fuqi.
- Nuk mund të kërkoj apo të pranoj udhëzime lidhur me kryerjen e detyrave të punës nga asnjë organ tjetër përveç Organit Drejtues të Qendrës Kompetencës dhe AAAPAR-së.
- Nuk lejohet shfrytëzimi i pozitës për përfitime private në dobi të ndonjë pale të tretë.
- Diagnostifikon kushtet për mësim dhe proceseve mësimore të nxënësve përmes proceseve të përshtatshme dhe reagon në mënyrën e duhur ndaj tyre, duke filluar masa të ndryshme mbështetëse individuale ndaj nxënësve.
- Puna monitorohet dhe vlerësohet mbi bazën e rezultateve të arritura të nxënësve sipas procedurave profesionale nga ana e ekspertëve përkatës.

Kualifikimi dhe shkathtësitë e kërkuara për mësimdhënës:

- Diploma e përgatitjes profesionale e nivelit të 7 sipas KKK;
- Letërnjoftimi (fotokopje);
- Certifikata për trajnimet e kryera;
- Vërtetimin e përvojës punës në arsim;
- Për të gjitha vendet e shpallura në konkurs kërkohet për gatitja adekuate profesionale;
- Ai ose ajo duhet të jenë në gjendje të punojnë nën trysni, të ketë etikë të lartë të punës dhe shkallë të lartë integriteti;
- Në mungesë të kandidatëve të kualifikuar pranohen dhe kandidatët me kualifikime të përafërt në afat të caktuar.
- Në kushtet të barabarta, përparësi do të kenë kandidatët të cilët janë duke punuar në të njëjtin vend të punës.

Procedurat e konkurrimit:

Afati i konkurrimit është 15 ditë pas shpalljes. Aplikacionet dhe dokumentet e kërkuara duhet të merren dhe dorëzohen në administratën e institucioneve në të cilat është shpallur konkursi në (Qendrën e Kompetencës në Ferizaj, Sh. M. M "Shtjefen Gjeqovi" në Prishtinë).

Aplikacionet duhet t'i bashkëngjiten, kopjet e dokumentacionit mbi kualifikimin, (për të diplomuarit jashtë vendit dëshmitë e nostrifikimit të diplomës), dëshmia për përvojën e punës, dëshmia që nuk janë nën hetime dhe dokumentacionet tjera të nevojshme që kërkohen për vendin e punës.

Kërkesat e arritura pas mbylljes së konkursit, dhe aplikacionet e pa kompletuara nuk shqyrtohen. Kandidatët të cilët do të ftohen në intervistë duhet t'i sjellin në shikim dokumentet origjinale.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

► Qerim Ferataj shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shf "Bajram Curri" Romajë.

► Urim Cocaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shf "Zenun Çoçaj" Gjonaj.

► Leutrim Ahmetaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - IX shf "Dëshmoret e Kabashit" Korish.

► Leutrim Ahmetaj shpall te pavlefshme dëftesat dhe diplomën shmit "11 Marsi" Prizren.

► Tamara Marjanovic shpall te pavlefshme dëftesat dhe diplomën shme "Ymer Prizreni" Prizren.

► Kaltrina Krasniqi shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - IX shf "Naim Frasheri" Vlashnje.

► Sami Tahiri shpall te pavlefshme dëftesën e shkollës fillore "Abedin Rexha" Turigevc, Skenderaj.

► Rafet Veseli shpall te pavlefshme dëftesën e shkollës "Abedin Rexha" Turigevc, Skenderaj.

► Agron Veli shpall te pavlefshme dëftesën e shkollës fillore "Drenica" Polac, Skenderaj.

► DPH "Te Adnani" shpall te pavlefshme numrin e biznesit : 70697246 me pronar Akgyn Kera, Vushtrri.

► Bashkëpronarja Vesna Grujic shet pjesën e vetë ideale në parcelën kadastrale P-70202018-00001K-0 Zona Kadastrale Gojbule Komuna e Zveçanit. Ftohen bashkëpronaret që nëse janë të interesuar për blerje të kësaj prone të lajmërohen te i autorizuari i saj Savic Dimitrije nga Zveçani.

► Urgjentisht kërkoj banesë me qira për një çift ne Fushe Kosove. Banesa duhet te ketë një dhomë gjumi dhomë dite me kuzhine te jete e mobiluar, çmimi: 150-200 euro. Tel 044-741-155

► Urgjentisht kërkoj banesë me qira ne Prishtine, për një qift me një fëmijë. Banesa duhet te ketë 1 dhomë gjumi dhomë dite me kuzhine. Po ashtu të jetë e mobiluar si dhe të jetë afatgjatë. Çmimi 200 euro. Tel: 044-741-155

► Epet lokali me qira në rrugën "B" me sipërfaqe prej 214 m2. Lokali është i përshtatshëm për çfarë do lloj veprimtarie. Informatat në tel: 045-660-118.

► Shes Truallin në Pejë, për ndërtim lagja Dardania, trualli frekuenton në dy rrugë çmimi sipas marrëveshjes numri kontaktues 044-278-417.

► Shes Truallin në Pejë, për ndërtim lagja Dardania, trualli frekuenton në dy rrugë çmimi sipas marrëveshjes numri kontaktues 044-278-417.

► Lëshoj me qira banesën tri dhomëshe në Bregun e Diellit, mbraja konvikteve të studentëve, kati VI- lifti funksional, e rinovuar komplet me të gjitha elementet, e mobiluar, ka nxehe qendrore. Banesa lëshohet vetëm për familjar, për banesë duhet të lehet edhe depozitë prej një qeraje. Çmimi 350 euro, tel: 049-400-958

► Agjencia për patundshmëri "SAZANI", kërkon për blerje dhe lëshojmë me qira: banesa, shtëpi, lokale, troje dhe toka. Ndërmjetësojmë me korrektësi si dhe shesim disa sosh. Numri kontaktues: 044-207-474.

► Shes shtëpinë në rrugën "Haxhi Zeka" afër Shkollës Teknike në Prishtinë. Çmimi sipas marrëveshjes. Tel: 049-909-641.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Ulpiana" afër AAK-së në Prishtinë. Për informata më të hollësishme lajmërohuni në këtë numër të telefonit: 044-162-783

► Kimete Lanaj B.I. kërkon një punëkryes për ndërtimin e serrës me sipërfaqe prej 40 ari, me material të zinguar. Oferta zgjat 5 ditë nga dita e shpalljes në gazetë. Kontakti: 044-528-353.

► Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomëshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Caseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



AUTOSHKOLLA "RITMO - L"

**Auto Shkolla
"RITMO - L"
Prishtinë**

**Eksperienca jonë
- përfitimi i juaj.**

Ju mirëpret:

Stafi i Auto Shkollës " Ritmo -L "

Tel / kontakt:

044 248 173

044 200 604

044 375 333